

# **QENDRA PËR ARSIM PROFESIONAL DHE TRAJNIM**

## **ANALIZË**

**për nevojat e ndjekjes së destinacioneve të nxënësve pas  
përfundimit të arsimit të mesëm profesional**

**Shkup, 2013**

**Anëtarë të grupit të punës për përpunimin e Analizës:**

**1. mr. Zoran Jovçevski, Këshilltar në Qendrën për Arsim Profesional dhe Trajnim, Shkup**

**2. spec. Adrijana Isahi Paloshi, Këshilltar në Qendrën për Arsim Profesional dhe Trajnim, Shkup**

**3. mr. Roza Arsovska, Këshilltar në Qendrën për Arsim profesional dhe Trajnim, Shkup**

**Anëtarë të ekipit hulumtues:**

**1. Lepa Tërpçevska, Këshilltar në Qendrën për Arsim Profesional dhe Trajnim, Shkup**

**2. Elizabeta Jovanovska Radanoviç, Këshilltar në Qendrën për Arsim Profesional dhe Trajnim, Shkup**

**3. Branko Aleksovski, Këshilltar në Qendrën për Arsim Profesional dhe Trajnim, Shkup**

**4. mr. Lidushka Vasilevska, Këshilltar në Qendrën për Arsim Profesional dhe Trajnim, Shkup**

**5. Ridvan Zeqiri, Këshilltar në Qendrën për Arsim Profesional dhe Trajnim, Shkup**

**6. mr. Çedomir Dimovski, Këshilltar në Qendrën për Arsim Profesional dhe Trajnim, Shkup**

**7. dr. Llaste Spasovski, Këshilltar në Qendrën për Arsim Profesional dhe Trajnim, Shkup**

**Kordinator – spec. Adrijana Isahi Paloshi**

**Recenzent -**

## PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE.....	5
HYRJA.....	6
1. Pasqyrim global mbi arsimin e mesëm në Republikën e Maqedonisë.....	8
2. Gjendja ekzistuese në ndjekjen e arsimit të mesëm profesional në Republikën e Maqedonisë .....	12
3. Metodologjia dhe hulumtimi.....	14
3.1. Korniza e problemit dhe nevojat e hulumtimit.....	14
3.2. Objekti dhe qëllimi i hulumtimit.....	15
3.3. Detyrat e hulumtimit.....	16
3.4. Metodadat, teknikat dhe instrumentet e hulumtimit.....	17
3.5. Organizimi dhe rrjedhja e hulumtimit.....	19
3.5.1. Faza e përgatitjes.....	19
3.5.2. Faza e realizimit.....	20
3.5.3. Faza e analizës dhe interpretimit të rezultateve.....	20
3.5.4. Organizimi kohor i hulumtimit.....	21
4. Spektri i hulumtimit.....	22
5. Analiza dhe interpretimi i rezultateve të hulumtimit.....	26
5.1. Perceptimi i menaxhimit për ndjekjen e destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të procesit arsimor.....	27
5.2. Perceptimi i kuadrit arsimor për ndjekjen e destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të procesit të arsimit.....	37
5.3. Perceptimi i nxënësve për ndjekjen e destinacioneve të tyre pas përfundimit të procesit arsimor në shkollën profesionale.....	43
5.4. Perceptimi i punëdhënësve për ndjekjen e destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të procesit arsimor.....	53
5.5. Perceptimi i vetëqeverisjes lokale për ndjekjen e destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të procesit arsimor.....	63

5.6. Perceptimi i nxënësve që kanë përfunduar arsimin me status të të papunësuarit mbi ndjekjen e destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të procesit të arsimit.....	71
5.7. Perceptimi i institucioneve që janë kompetente për arsimin e mesëm profesional për ndjekjen e destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të procesit arsimor.....	73
6. Mendime përmbyllëse për ndjekjen sistematike të destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të procesit të arsimit.....	75
7. Rekomandime për ndërtimin e një sistemi për ndjekjen e destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të arsimit të mesëm profesional.....	78

## LISTA E SHKURTESAVE

- APRM** – Agjencia për Punësim në Republikën e Maqedonisë
- BZhA** – Byroja për Zhvillim të Arsimit
- QShP** – Qendra Shtetërore e Provimit
- IShA** – Inspektorati Shtetëror Arsimor
- ECVET** - European credit system for vocational education and training
- EMIS** – Educational Management Information System
- SIMA- Sistemi Informues për Menaxhim me Arsimin
- EQF** – European qualifications framework
- KEK – Korniza Evropiane e Kualifikimeve
- BE** – Bashkimi Evropian
- BNjVL – Bashkësia e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale
- TI** – Teknologjia Informatike
- MASH** – Ministria e Arsimit dhe Shkencës
- KNK** – Korniza Nacionale e Kualifikimeve
- ShPP** – Shërbimi Pedagogjik Psikologjik
- TP** – Tregu i Punës
- AMP** – Arsimi i Mesëm Profesional
- AP** – Arsimi Profesional
- APT** – Arsimi Profesional dhe Trajnimi
- ShMP** – Shkolla e Mesme Profesionale
- ShMQSh** – Shkolla e Mesme e Qytetit të Shkupit
- ShMET** – Shkolla e Mesme Elektroteknike
- ShMK** – Shkolla e Mesme e Komunës
- QAPT** – Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim
- QARr** – Qendra e Arsimit për të Rriturit

## HYRJE

Arsimi i mesëm profesional është një ndër faktorët kryesorë për zhvillimin e shoqërisë nga aspekti ekonomik, tekniko-teknologjik, kulturologjik, demografik apo ndonjë faktor tjetër. Para AMP-së janë vendosur tri funksione themelore: përgatitja për pjesëmarrje aktive të qytetarëve në zgjidhjen problemeve të ndryshme shoqërore, profesionale, familjare dhe individuale, aftësim të kuadrove/individëve kompetentë për përfshirje në tregun e punës kështu që në mënyrë të drejtpërdrejtë do të ndikohet mbi gjendjet në tregun e punës dhe përgatitje për vazhdim të arsimit në institucionet e arsimit të lartë, drejtpërdrejtë apo nëpërmjet arsimit nga puna dhe me punë.

Progresi i shpejtë shkencor-teknologjik kërkon integrim më të madh, lidhje të ndërsjellë midis shkencës dhe teknikës nga njëra anë dhe aktiviteteve të njeriut nga ana tjetër, kështu që kërkesat për kompetenca adekuate të cilat i fitojnë individët gjatë arsimit profesional bëhen gjithnjë dhe më të dukshme për t'u përfshirë në tregun e punës dhe për vijim të mëtejshëm të arsimit. E gjitha kjo ndikon që cilësia në arsimin e mesëm profesional duhet të mirëmbahet, rritet dhe ngrihet vazhdimisht në një nivel më të lartë. Intervenimet, ndryshimet në AMP mund të realizohen në shumë mënyra, nëpërmjet: ndryshimit të planeve dhe programeve arsimore, futjes së formave dhe metodave të reja të punës, trajnimit të kuadrit edukativ-arsimor, pajisjes së shkollave etj.

Por, a është kuptimplotë një intervenim, ndryshim i caktuar në AMP pa të dhëna dhe tregues relevantë?

Motivi kryesor i Analizës së nevojave të ndjekjes së destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të shkollës së mesme profesionale (në rrjedhën e mëtejshme të materialit Analizë), është njohuria se arsimi i mesëm profesional i cili kërkon ndryshime, në të vërtetë është, edhe shumë i ndjeshëm ndaj ndryshimeve, nëse ato nuk janë të argumentuara dhe të mbështetura me të dhëna dhe tregues relevantë për arsyeshmërinë e tyre.

Analiza jep njohuri të përdorshme për nevojat e ndjekjes së destinacioneve të nxënësve të cilët e kanë përfunduar AMP-në, në këtë drejtim në plan afatgjatë mund të bëhen ndryshime pozitive në kulturën shkollore organizative-teknike,

kurse pritet që njohuri të caktuara mund të kalojnë në standarde të miratuara të arsimit profesional në Republikën e Maqedonisë.

Analiza jep një pamje të qartë për gjendjen e tanishme në ndjekjen e destinacioneve të nxënësve të cilët e kanë përfunduar AMP, kurse me vetë këtë hap mundësi për përmirësim të gjendjeve në raport me përshtatshmërinë, shfrytëzimin dhe qëndrueshmërinë e ndjekjes sistematike të arsimit profesional. Gjithashtu, pritet që Analiza të shkaktojë një interes më të madh për përfshirje dhe pjesëmarrje përkatëse të institucioneve, të cilat e krijojnë arsimin, të cilat e realizojnë procesin e arsimit, institucioneve shkencore dhe institucioneve për mbështetje të AMP-së që të vendosen parimet dhe faktorët për dizajnim të bazave të nevojshme të të dhënave para së gjithash për shkak të cilësisë më të madhe në planifikimin dhe dizajnimin e rrjetit të arsimit profesional, si edhe rritjes së cilësisë në lidhjen e arsimit profesional me tregun e punës dhe me arsimin e lartë.

## **1. Pasqyrim global mbi arsimin e mesëm në Republikën e Maqedonisë**

Sistemi arsimor në Republikën e Maqedonisë e paraqitur në Figurën 1 realizohet në tri nënsistemet e tij: tetëvjeçar, i mesëm dhe i lartë.



Në vitin 2007, me miratimin e Ligjit për Arsim të Mesëm të Obliguar<sup>1</sup>, arsimi i mesëm i cili kryhej në dy lloje: arsim gjimnazial (i përgjithshëm) dhe profesional merr status të obliguar. Arsimi gjimnazial përgatit kuadro, para së gjithash, për vazhdim të arsimit, kurse arsimi profesional përgatit kuadro së pari për puno, por edhe për vazhdim të arsimit. Raporti i numrit të nxënësve në AMP dhe arsimin gjimnazial është 58% në arsimin profesional përkundrejt 42% në arsimin gjimnazial<sup>2</sup>.

Sipas Ligjit për Arsimin e Mesëm, arsimi i mesëm, ndërsa me këtë edhe AMP realizohet në shkollat e mesme me status shkolla publike dhe private. Shkollat publike mund të jenë shtetërore, komunale dhe shkolla të Qytetit të Shkupit. Rrjetin e shkollave publike e përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të ministrit të resorit<sup>3</sup>. Arsimi i mesëm në shtet realizohet në 99 shkolla publike (8 shtetërore, 66 komunale, 4 Qendra për Rehabilitacion dhe 21 shkolla të Qytetit të Shkupit)<sup>4</sup>.

Nga viti 1991 përfaqësuesit e nacionaliteteve kanë të drejtë të shkollohen në gjuhën e vet në shkollën e mesme, sipas mënyrës të përcaktuar me ligj.

Me Ligjin për Arsimin e Mesëm të vitit 1995 është përcaktuar se veprimtaria edukuese-arsimore në shkollat publike për arsim të mesme mund të zhvillohet në gjuhën dhe alfabetin e nacionaliteteve, por, nxënësit e nacionaliteteve e mësojnë edhe gjuhën maqedonase si të obligueshme.

Sipas ligjit të mësipërm në shkollat e mesme profesionale mësimi mund të kryhet edhe në një prej gjuhëve botërore, kurse në shkollat private edhe në gjuhë tjetër të huaj<sup>5</sup>.

Arsimi i mesëm është i rregulluar juridikisht dhe normativisht me shumë akte ligjore dhe nënligjore.

---

<sup>1</sup> Ligji për Arsimin e Mesëm, (ndryshime dhe plotësime) "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.49/07 më 18.04.2007

<sup>2</sup> "Evalvim kolaborues i ndikimit të arsimit të mesëm profesional katërvjeçar të reformuar", MASH, FET, QAPT, fq. 41, Shkup, 2010.

<sup>3</sup> Ligji për Arsimin e Mesëm (tekst i pastruar), "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.52 11 korrik 2002.

<sup>4</sup> Konkurs për regjistrim të nxënësve në shkollat e mesme publike në vitin shkollor 2012/2013 në Republikën e Maqedonisë, MASH, 2013

<sup>5</sup> "Evalvim kolaborues i ndikimit të arsimit të mesëm profesional katërvjeçar të reformuar", MASH, FET, QAPT, fq. 19, Shkup, 2010.

Arsimi profesional mund të realizohet si: aftësim profesional, arsim profesional për profesione, arsim teknik, arsim pas arsimit të mesëm dhe arsim për të rriturit<sup>6</sup>.

Numri më i madh i nxënësve në sistemin formal të arsimit të mesëm profesional janë në arsimim teknik dhe profesional për profesione (më tepër se 90%)<sup>7,8,9</sup>. Planet arsimore që realizohen në këto dy segmente të arsimit janë kompozitë e tri pjesëve: arsim i përgjithshëm, arsim profesional dhe trajnim praktik.

Në arsimin e përgjithshëm realizohen programe mësimdhënëse të përgjithshme arsimore, në arsimin profesional realizohen programe mësimdhënëse profesionale dhe në trajnimin praktik realizohen programe për mësimdhënien praktike. Për të gjitha programet mësimdhënëse janë përcaktuar normativa për përkatësinë e kuadrit arsimor i cili duhet t'i realizojë programet mësimdhënëse.

Arsimi i mesëm profesional në arsimin teknik realizohet në 14 profesione dhe 48 profile arsimore<sup>9</sup>, gjatë kësaj tendenca është që numri i profesioneve 26 në arsimin profesional dyvjeçar dhe trevjeçar<sup>10</sup> të bëhet 14, si në AMP-në katërvjeçare.

Sipas programeve arsimore të cilat realizohen në shkollat publike, në 15 shkolla realizohet arsim gjimnazial, në 43 shkolla arsim profesional, në 35 shkolla realizohet arsim gjimnazial dhe profesional, në pesë shkolla arsim artistik, 1 gjimnaz sportiv, kurse 4 shkolla janë për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore<sup>11</sup>.

---

<sup>6</sup> Ligji për Arsimin Profesional dhe trajnimin "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.71. më 08.06.2006.

<sup>7</sup> Konkurs për regjistrim të nxënësve në shkollat e mesme publike në vitin shkollor 2010/2011 në Republikën e Maqedonisë, MASH, 2011.

<sup>8</sup> Konkurs për regjistrim të nxënësve në shkollat e mesme publike në vitin shkollor 2011/2012 në Republikën e Maqedonisë, MASH, 2012.

<sup>9</sup> Konkurs për regjistrim të nxënësve në shkollat e mesme publike në vitin shkollor 2012/2013 në Republikën e Maqedonisë, MASH, 2013.

<sup>10</sup> Planet mësimore për profilet arsimore me afat katërvjeçar dhe trevjeçar në arsimin e mesëm profesional në Republikën e Maqedonisë. Byroja e Zhvillimit të Arsimit, Shkup, qershor, 2002.

<sup>11</sup> Konkurs për regjistrim të nxënësve në shkollat e mesme publike në vitin shkollor 2012/2013 në Republikën e Maqedonisë, MASH, 2013.

Numri i shollave të mesme profesionale sipas profesioneve janë: për bujqësi-veterinë – 11, pyjetari-përpunim druri – 7, gjeologjike-miniera dhe metalurgjike – 5, makineri 23, elektroteknike 17, kimike-teknologjike – 11, tekstile-lëkurëpunuese 14, grafike – 7, shërbime individuale – 8, ndërtimore-gjeodete – 6, qarkullimi – 11, hotelierike-turistike -9, ekonomike-juridike dhe tregtare – 16 dhe shëndetësore - 14<sup>12</sup>.

Gjendja është e tillë që numri më i madh i shkollave profesionale janë me përbërje heterogjene ku realizohet arsim gjimnazial dhe AMP ose realizohen disa degë arsimore.

Mësimi realizohet në paralele sipas Ligjit për Arsimin e Mesëm lejohet që numri maksimal i nxënësve në një paralele të jetë 34, kurse numri mesatar i nxënësve për paralele, sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikës për vitin shkollor 2008/2009 ka qenë 28,94 nxënës për numrin e përgjithshëm prej 94545 nxënësve në shkollën e mesme<sup>13</sup>.

Për realizimin e programeve mësimore për lëndët profesionale teorike dhe mësimin praktik, nevojiten mjete arsimore, pajisje dhe materiale, që për shkolla të caktuara është problem në realizim për shkak se ato mungojnë. Përfundimi i shkollës së mesme profesionale është rregulluar me dhënien e maturës shtetërore dhe provimit përfundimtar<sup>14</sup>.

---

<sup>12</sup> Konkurs për regjistrim të nxënësve në shkollat e mesme publike në vitin shkollor 2009/2010 në Republikën e Maqedonisë, MASH, 2010.

<sup>13</sup> Vjetari statistikor, Enti Shtetëror i Statistikës në Republikën e Maqedonisë, Shkollat tetëvjeçare dhe të mesme në fillim të vitit shkollor 2008/2009.

<sup>14</sup> Ligji për Arsimin e Mesëm, (ndryshime dhe plotësime) “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.81/08 më 07.07.2008.

## **2. Gjendja ekzistuese në ndjekjen e arsimit të mesëm profesional në Republikën e Maqedonisë**

Në periudhën e kaluar është trajtuar shumë pak ndjekja sistematike e arsimit të mesëm profesional në Republikën e Maqedonisë. Futja e teknologjisë informatike në sistemin arsimor, kurse ndërmjet kësaj edhe në arsimin e mesëm profesional filloi provokojë dhe hapë mundësi dhe nevoja të caktuara për informacione të shumëllojshme të sakta dhe precize, organizim dhe azhurnim të të dhënave për shkak të përdorimit përkatës etj. Por, e gjitha ajo që ndodhte ka qenë incidente, e krijuar me entuziazëm dhe e vendosur pa zgjidhje sistematike dhe pa përkushtim përkatës mbi rëndësinë e nevojës për ndjekjen e tërësishme të arsimit të mesëm profesional.

Hapi më i madh në raport me ndjekjen e AMP-së është bërë në vitin 2010 me iniciativë për vendosjen e aplikacionit SIMA – Sistem Informatik për Menaxhim me Arsimin (Educational Management Information System – EMIS).

Aplikimi SIMA, i cili është i bazuar në WEB, është mjet për mbledhje, kontroll dhe prezantim të të dhënave/informacioneve që janë të rëndësishme për procesin arsimor në arsimin tetëvjeçar dhe të mesëm në R. e Maqedonisë. Ky sistem duhet të kontribuojë për një proces transparent dhe efikas të financimit të arsimit të sistemit arsimor të decentralizuar, me mundësi për rekonstruksione dhe investim në infrastrukturën e shkollave, zhvillimin e vazhdueshëm të personelit arsimor dhe personelit tjetër, si dhe ndjekje e procesit të edukimit të nxënësve.

SIMA – sistemi për menaxhim me arsimin është sistem i integruar i cili e optimizon procesin e mbledhjes së të dhënave, komunikimin me institucione të tjera, si dhe gjenerim të të gjitha raporteve dhe statistikave të domosdoshme. SIMA i mbledh, përpunon dhe prezanton të dhënat për nxënësit, si dhe për arritjet e tyre në procesin arsimor në shkollat e mesme dhe publike në R. e Maqedonisë.

SIMA përmban edhe kontroll të gjitha proceseve dhe procedurave të dhëna më sipër të cilat janë në kompetencë të Inspektoratit Shtetëror të Arsimit.

Baza e të dhënave mbi të cilën punon kjo zgjidhje aplikative është e familjes ORACLE dhe e versionit ORACE 11g. Sistemi mundëson ekstrahim konzistent të të dhënave në XML, MS Excel dhe formate dokumentesh të

ngjashme, nëpërmjet të cilave shkëmbimi i të dhënave me sistemet e tjera është i thjeshtë. Aplikimi është i bazuar në WEB dhe i mundëson konsumatorit qasje tek ai nëpërmjet cilitdo internet klienti. Që ta shfrytëzojë konsumatori sistemin i nevojitet kompjuter personal i cili është i lidhur me Internetin ose me Rrjetin Intranet i cili është i lidhur me Internetin që të mund të hyjë deri në server d.m.th. vendin ku është vendosur Internet Aplikimi.<sup>15</sup>

SIMA nuk e trajton çështjen e ndjekjes së destinacioneve të nxënësve që kanë përfunduar AMP e cila është komponent i rëndësishëm për zhvillimin e planifikuar të arsimit të mesëm profesional.

---

<sup>15</sup> Sistemi Informatik për Menaxhim me Arsimin (Educational Management Information System – EMIS), Udhëzim për përdorim, Vers. PA1, Ultra ShPK, Shkup 2010

### **3. Metodologjia e hulumtimit**

#### **3.1. Korniza e problemit dhe nevojat e hulumtimit**

Arsimi është kushti kryesor për mbijetesë dhe zhvillim të cilësdo shoqëri moderne. Në kushte të ndryshimeve të shpejta demografike, sociale, politike, ekonomike dhe shkencore-teknologjike rëndësia e tij është zmadhuar shumë. Ai ka rol vital në zhvillimin ekonomik të shoqërisë bashkëkohore dhe hapjen e hapësirës për pjesëmarrje aktive të qytetarëve në zgjidhjen e problemeve të ndryshme shoqërore, profesionale, familjare dhe individuale.

Arsimi i mesëm profesional është me rëndësi të jashtëzakonshme për individin sepse mundëson fitim të njohurive, aftësive dhe shkathtësive, përkatësisht kompetencave të nevojshme për përfshirje në tregun e punës dhe/apo për vazhdim të arsimit në institucionet e arsimit të lartë. Vendorsja e tillë e AMP-së në sistemin e arsimit të mesëm nxit nevojë për ndjekje sistematike të nxënësve pas përfundimit të arsimit të mesëm profesional në raport të përkatësisë së tyre në tregun e punës dhe në arsimin profesional.

Ndjekja e destinacioneve të nxënësve që kanë përfunduar është më se e nevojshme, para së gjithash për shkak të:

- krijimit të parakushteve për planifikim më të mirë dhe më kuptimplotë të procesit arsimor në shkollat profesionale;
- drejtimit më të mirë profesional të nxënësve pas përfundimit të arsimit profesional;
- cilësisë dhe sasisë së zmadhuar të qasjes individuale në sistemin arsimor;
- ndryshimeve të tërësishme në rrjetin e shkollave profesionale;
- harmonizimit më të mirë midis AMP-së dhe tregut të punës; dhe
- përmirësimit të cilësisë së sistemeve të ardhshme të evalvimeve në arsimin profesional në Republikën e Maqedonisë.

### **3.2. Objekti dhe qëllimi i hulumtimit**

Objekt i këtij hulumtimi është përcaktimi i nevojave për ndjekjen e destinacioneve të nxënësve që kanë përfunduar shkollën pas përfundimit të procesit arsimor në shkollën profesionale.

Duke i ndjekur trendet evropiane dhe projektet e shumta që janë realizuar këta dhjetë vjetët e fundit në Republikën e Maqedonisë u parashtrua pyetja: “Çfarë ndodh me nxënësit pas përfundimit të shkollës së mesme profesionale?”.

Përgjigjet më të shpeshta të shkollave dhe të institucioneve të tjera ishin të pabaza, pa të dhëna relevante për oscilimin, për përfshirjen e nxënësve që kanë përfunduar shkollën në tregun e punës dhe për vazhdimin e mëtejshëm të arsimit në institucionet e arsimit të lartë, për arsye se nuk ekziston një sistem për ndjekjen e përkatësisë së nxënësve që kanë përfunduar procesin arsimor, përkatësisht nuk kanë të dhëna. Kjo implikon, planifikime të këqija, intervenime jo kuptimplota në zvogëlimin apo zmadhimin e rrjetit të shkollave të mesme, lidhje me cilësi të pamjaftueshme midis arsimit profesional me tregun e punës dhe me arsimin e lartë.

Hulumtimi ka për qëllim të përcaktojë gjendjen ekzistuese në raport me ndjekjen e destinacioneve të nxënësve që kanë përfunduar shkollën dhe hapjen e mundësive për përmirësim të gjendjes në këtë sferë.

### 3.3. Detyra të hulumtimit

Në përputhje me objektin e hulumtimit dhe në drejtim të realizimit të qëllimit të hulumtimit, përkatësisht operacionalizim të tij, është e nevojshme një vendosje e caktuar dhe realizim i detyrave të hulumtimit.

Detyra të hulumtimit janë:

- Skenimi i gjendjes së tanishme në raport me ndjekjen e destinacioneve të nxënësve që kanë përfunduar shkollën e mesme profesionale.
- Përcaktimi i nevojës së ndjekjes së destinacioneve të nxënësve që kanë përfunduar ShMP-në.
- Identifikimi i institucioneve të cilat nevojitet të përfshihen në vendosjen, funksionimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ndjekjes.
- Përcaktimi i përgaditshmërisë së shkollave të mesme profesionale për pjesëmarrje në ndjekjen e nxënësve të vet që kanë përfunduar arsimin, përkatësisht, kujdes i mëtejshëm për nxënësit e vet pas lëshimit të ShMP, si nxënës që kanë përfunduar.
- Hulumtimi i mundësive dhe mënyrave për funksionim interaktiv të shkollave të mesme profesionale me nxënësit që kanë përfunduar në raport me ndjekjen e tyre të mëtejshme.
- Detektim i gjendjes me pajisje teknike-teknologjike në ShMP.
- Vendosja e drejtimeve për ligjshmërinë në vendosjen, shfrytëzimin dhe mbajtjen e bazave të të dhënave në ndjekjen e ShMP.



### **3.4. Metoda, teknika dhe instrumente të hulumtimit**

Nga aspekti metodologjik, në suazat e hulumtimit janë përdorur:

- Metoda operative:
  - deskriptim
  - krahasim
  - vlerësim dhe reflektim
  - analizim i subjekteve
- Procedura të hulumtimit:
  - analizë e përmbajtjes
  - intervistë
- Instrumente të hulumtimit:
  - protokoll për mbajtjen e intervistës
  - pyetësorë

Në hulumtim burime kryesore të të dhënave ishin pesë pyetësorët e ndryshëm dedikuar: menaxhmentit, kuadrit arsimor dhe nxënësve të ShMP-së, punëdhënësve, bashkësisë lokale, si dhe intervista të kryera me grupet e fokusit të personave të papunësuar të cilët kanë përfunduar AMP-në në vitin shkollor 2007/08 dhe 2008/09 dhe intervistat e kryera me përfaqësuesit e institucioneve kompetente për AMP. Të gjitha këto instrumente janë dizajnuar nga autorët e këtij studimi për nevojat e hulumtimit, duke pasur parasysh objektin, qëllimet dhe detyrat e hulumtimit.

Pyetësori për menaxhmentin përmban 23 pyetje, 22 pyetje janë të llojit të mbyllur dhe një pyetje e llojit të hapur. Pyetësori është strukturuar të japë të dhëna në bazë të perceptimit të menaxhmentit për gjendjet dhe nevojat për ndjekjen sistematike të destinacioneve të nxënësve që kanë përfunduar AMP-në.

Pyetësori për kuadrin arsimor përmban 20 pyetje, 17 prej tyre janë pyetje të hapura dhe tri janë pyetje të hapura. Pyetësori është strukturuar të japë të dhëna në bazë të perceptimit të kuadrit arsimor për gjendjet dhe nevojat për ndjekje sistematike të destinacioneve të nxënësve që kanë përfunduar AMP-në.

Pyetësi për nxënësit përmban 22 pyetje, 19 prej tyre janë pyetje janë pyetje të hapura dhe tri janë pyetje të hapura. Pyetësi është strukturuar të japë të dhëna në bazë të perceptimit të nxënësve për gjendjet dhe nevojat për ndjekje sistematike të destinacioneve të tyre pas përfundimit të AMP-së.

Pyetësi për punëdhënësit përmban 15 pyetje, prej të cilave 13 pyetje janë pyetje të hapura dhe dy janë pyetje të hapura. Pyetësi është strukturuar të japë të dhëna në bazë të perceptimit të punëdhënësit për gjendjet dhe nevojat për ndjekje sistematike të destinacioneve të nxënësve që kanë përfunduar AMP-në.

Pyetësi për vetëqeverisjen lokale përmban 16 pyetje, prej të cilave 11 pyetje janë pyetje të hapura dhe tri janë pyetje të hapura. Pyetësi është strukturuar të japë të dhëna në bazë të perceptimit të përfaqësuesve të sektorit për arsim në Komunë për gjendjet dhe nevojat për ndjekje sistematike të destinacioneve të nxënësve që kanë përfunduar AMP-në.

Një dedikim i ngjashëm i sigurimit të të dhënave për gjendjet dhe nevojat për ndjekjen sistematike të destinacioneve të nxënësve që kanë përfunduar AMP patën edhe intervistat e realizuara me grupet e fokusit, personat e papunësuar dhe me përfaqësuesit e institucioneve kompetente për AMP.

Gjithashtu për nevojat e hulumtimit janë analizuar shumë dokumente siç janë: Ligji për Shkollën e Mesme, Ligji për Arsimin Profesional dhe për Trajnim, Raportin për Evalvimin Kolaborativ të Ndikimit të Arsimin Profesional të Mesëm Katërvjeçar të Reformuar, konkurset për regjistrim të nxënësve në shkollën e mesme ej, me qëllim që të sigurohen të dhëna dhe tregues relevantë mbi gjendjet dhe nevojat për ndjekje sistematike të nxënësve që kanë përfunduar AMP-në.

### **3.5. Organizimi dhe rrjedha e hulumtimit**

Hulumtimi ishte organizuar dhe realizuar në tri faza:

- a) faza e përgatitjes;
- b) faza e realizimit; dhe
- v) faza e analizimit dhe interpretimit të rezultateve.

#### **3.5.1. Faza e përgatitjes**

Në periudhën e fazës së përgatitjes ishte planifikuar se çfarë do të bëhet për realizimin me sukses të hulumtimit. Për këtë qëllim:

- u përgatit baza e pyetjeve të cilat ishin bazë për dizajnim të pyetësorëve dedikuar menaxhmentit, kuadrit arsimor, nxënësve, punëdhënësve, vetëqeverisjes lokale, grupeve të fokusit të personave të papunësuar dhe përfaqësuesve të institucioneve kompetente për ShMP;
- u krye segmentimi i profesioneve të cilat ekzistojnë në arsimin e mesëm profesional në pesë sektorë (teknik, shoqëror, shëndetësor, bujqësor dhe sektorin e shërbimeve);
- u përcaktua numri i të anketuarve për çdo grup, si përqindja, numri dhe lloji i shkollave të mesme profesionale të cilat do të përfshihen në hulumtim;
- u kryen biseda informuese me menaxhmentin e të gjitha shkollave profesionale të përfshira dhe me personat kompetentë të EPRM-së që të njihen me objektin dhe qëllimet e hulumtimit;
- nga drejtorët e shkollave ishin përcaktuar persona përgjegjës të cilët ishin kompetentë t'i realizonin pyetësorët në shkollat e veta;
- janë përpunuar versionet finale të instrumenteve për mbledhjen e të dhënave;
- instrumentet janë fotokopjuar në përputhje me numrin e përcaktuar të të anketuarve;
- janë përcaktuar dokumente të llojit të Ligjeve dhe akteve nënligjore, raporteve, analizave, evalvimeve, programeve, konkurseve për regjistrim të nxënësve në AMP, të cilat do të përdoren në hulumtim.

### **3.5.2. Faza e realizimit**

Në periudhën e fazës së realizimit në mënyrë operative u realizua mbledhja e të dhënave nëpërmjet instrumenteve të parashikuara dhe të përpunuara.

Për këtë qëllim:

- u dorëzuan pyetësoret në çdo shkollë me numrin e saktë të përcaktuar;
- në termin e dakorduar pyetësoret e plotësuar janë dorëzuar nga shkollat në ekipin hulumtues;
- u krye kontroll kuantitativ dhe klasifikim i pyetësorëve në raport me grupet e të anketuarve;
- u realizuan intervista me grupet e fokusit, personat e papunësuar dhe përfaqësuesit e institucioneve kompetente për AMP;
- u siguria dokumentacioni i nevojshëm për nevojat e hulumtimit.

### **3.5.3. Faza të analizës dhe interpretimit të rezultateve**

Në periudhën e fazës së analizës dhe interpretimit të rezultateve, të dhënat e marra nga menaxhmenti, kuadri arsimor, nxënësit, punëdhënësit, vetëqeverisja lokale, personat e papunësuar dhe përfaqësuesit e institucioneve kompetente për AMP, u përpunuan në drejtim të objektit të hulumtimit, qëllimeve dhe detyrave. Për këtë qëllim:

- u përgatit programi në Microsoft Office Excel për përpunim statistikor të të dhënave;
- të dhënat ishin vendosur dhe përpunuar në mënyrë statistikore në raport me çdo të anketuar me çdo pyetje;
- çdo pyetje ishte analizuar dhe interpretuar në përputhje me qëndrimet e të anketuarve dhe të institucioneve;
- përfundimet interpretoheshin në bazë të treguesve evidentë të cilët janë të argumentuara në mënyrë statistikore, si dhe deklaratat e marra grupet e fokusit;
- u dhanë qëndrime të caktuara në bazë të analizës së dokumentacionit relevant dhe përvojës shumëvjeçare të fituar nga Autorët e Analizës në AMP.

### 3.5.4. Organizimi kohor në hulumtim

Hulumtimi u realizua për një afat kohor efektiv prej pesë muajsh. Organizata kohore, përkatësisht dimensionimi kohor i hulumtimit është dhënë në Tabelën 1.

Tabela 1: Organizimi kohor i hulumtimit																				
Faza	Viti 2013 – muaj - javë																			
	Muaj – 1				Muaj – 2				Muaj – 3				Muaj – 4				Muaj – 5			
	-	=	≡	≥	-	=	≡	≥	-	=	≡	≥	-	=	≡	≥	-	=	≡	≥
Përgatitja																				
Realizimi																				
Analiza dhe interpretimi i rezultateve																				

#### 4. Spektri i hulumtimit

Pjesa më e madhe e arsimit të mesëm profesional formal në Republikën e Maqedonisë, mbi 80% e arsimit profesional të përgjithshëm, realizohet si arsim teknik me afat prej katër vjetësh. Për këtë arsye, dhe për arsye se arsimi teknik mundëson përfshirjen e nxënësve që kanë përfunduar arsimin e mesëm në TP dhe kalimin në arsimin e lartë me kalimin me sukses të maturës shtetërore, spektri i hulumtimit është me fokus tek ky lloj arsimi profesional që realizohet në 14 profesione dhe 48 profile arsimore<sup>16</sup> në 78 ShMP publike<sup>17</sup>.

Hulumtimi është dizajnuar në bazë të plotësimit të dy prej kriterëve të mëposhtme:

- të ketë përfshirje sektoriale të përgjithshme dhe
- të përfshihen nxënësit e vitit të katërt në AMP.

Me sektor në këtë hulumtim kuptojmë grupin e profesioneve arsimore të ngjashme dhe të afërme, apo një profesion i cili për shkak të specifikës së vet nuk mund të jetë në korrelacion me ndonjë profesion tjetër të ngjashëm apo të afërm. Spektri i përgjithshëm sektorial mundëson të përfshihen të 14 profesionet e arsimit të mesëm profesional teknik (katërvjeçar) në pesë sektorë: teknik, shoqëror, shëndetësor, bujqësor dhe sektori i shërbimeve. Përkatësia e veçantë e profesioneve në raport me sektorët është dhënë në Tabelën 2.

<b>Tabela 2. Përkatësia e mëvetësishme e profesioneve në raport me sektorët</b>		
<b>NR. R.</b>	<b>SEKTORI</b>	<b>PROFESIONI</b>
1.	Teknik	- Elektroteknik - Makinerie - Qarkullim - Ndërtimor-gjeodet - Gjeologjik-minierash dhe metalurgjik

<sup>16</sup> Planet arsimore për profilet arsimore në profile apo grupe profilesh në arsimin profesional katërvjeçar në Republikën e Maqedonisë, Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim, Shkup, 2007.

<sup>17</sup> Konkurs për regjistrim të nxënësve në shkollat e mesme publike në vitin shkollor 2012/2013 në Republikën e Maqedonisë, MASH, 2013 .

		- Kimik-teknologjik - Tekstil dhe i lëkurës
2.	Shoqëror	- Ekonomik, juridik dhe tregtar
3.	Shëndetësor	- Shëndetësor
4.	Bujqësor	- Bujqësor-veterinar - Pyje dhe përpunim i drurit
5.	I Shërbimeve	- Grafik - Hotelierik-turistik - Shërbime personale

Përfshirja e nxënësve që kanë përfunduar vitin e katërt në AMP mundëson marrjen e informacioneve relevante nga individë të cilët pothuajse e kanë kaluar procesin e arsimit dhe duhet të vazhdojnë zhvillimin e tyre të mëtejshëm.

Në hulumtim përfshirja sektoriale e përgjithshme ishte realizuar në 16 shkolla profesionale dhe gjatë procesit të hulumtimit ishin anketuar:

- 51 përfaqësues të menaxhmentit të shkollave të mesme profesionale (drejtorë-16, ndihmësdrejtorë – 17, pedagogë dhe psikologë -18);
- 247 arsimtarë të cilët realizojnë mësimin në këto shkolla profesionale, prej të cilëve 109 arsimtarë apo 44% realizojnë mësimdhënie për lëndë të përgjithshme arsimore dhe 138 apo 56% arsimtarë që realizojë mësimdhënie për lëndë profesionale dhe
- 344 nxënës të vitit të katërt.

Përfshirja e mëvetësishme e profesioneve arsimore, menaxhmentit, arsimtarëve dhe nxënësve në raport me shkollat profesionale të përfshira në hulumtim është dhënë në Tabelën 3.

Përveç pjesës së hulumtimit, për ndjekje sistematike të destinacioneve të nxënësve që kanë përfunduar arsimin, të zbatuar në shkollat profesionale, është realizuar dhe hulumtim në Agjencinë e Punësimit në Republikën e Maqedonisë i 128 personave të papunësuar, prej të cilëve tre kanë përfunduar arsimin e vet profesional në vitin shkollor 2007/2008, kurse 125 kanë përfunduar arsimin e vet profesional në vitin shkollor 2008/2009. Gjatë kësaj, përfshirja në raport me

sektorët ishte si vijon: 46 të anketuar nga sektori teknik, 22 të anketuar nga sektori shoqëror, 20 të anketuar nga sektori shëndetësor, 16 të anketuar nga sektori bujqësor dhe 24 të anketuar nga sektori i shërbimeve.

Gjithashtu në këtë Analizë janë përfshirë edhe 13 Komuna dhe Qyteti Shkup, 28 punëdhënës/kompani dhe institucione kompetente për AMP (MASH, BZHA dhe QAPT).

<b>Tabela 3: Përfshirja në raport me profesionet e përfaqësuara në shkolla</b>					
Nr.r.	Shkolla	Profesione	Menaxhment	Arsimtarë	Nxënës
1.	ShMQSh "Vllado Tasevski"- Shkup	-Elektroteknikë -Makineri -Qarkullim	4	27	30
2.	ShMET "Mihajlo Pupin" - Shkup	-Elektroteknikë	4	10	20
3.	ShMQSh "Panço Karagjozov" - Shkup	-Shëndetësor	3	16	20
4.	ShMQSh "Llazar Tanev" - Shkup	-Hotelirei-turizëm	3	10	20
5.	ShMQSh "Mari Kyri Skllodovska" – Shkup	-Kimik-teknologjik -Shërbime personale	4	15	21
6.	ShMQSh "Cvetan Dimov" - Shkup	-Ekonomik, juridik dhe tregtar	4	13	20
7.	ShMK "Kiro Burnjaz" – Kumanovë	-Bujqësor-veterinar -Kimik-teknologjik - Shërbime personale	4	12	16
8.	ShMK "Jane Sandanski" Shtip	-Profesion shëndetësor	1	24	16
9.	ShMK "Gjorçe Petrov" - Kavadarci	Pyje-përpunim druri -	3	15	20
10.	ShMK "Kole Nedellkovski" – Veles	-Elektroteknikë -Makineri -Qarkullim	3	15	21
11.	ShMK "Gjorgji Naumov" - Manastir	-Elektroteknikë -Makineri	3	15	20
12.	ShMK "Dimitar Vllahov" - Strumicë	-Bujqësor-veterinar	3	15	20
13.	ShMK "Gostivar" – Gostivar	-Ekonomik, juridik dhe tregtar	3	15	40
14.	ShMK "Riste Ristevski Riçko" – Prilep	-Elektroteknikë -Makineri -Grafik	3	15	20



15.	ShMK "Moshë Pijade"- Tetovë	-Bujqësor-veterinar -Kimik-teknologjik -Hotelierik-turistik -Elektroteknik	3	15	20
16.	ShMK"Vanço Pitoshevski" – Ohër	- Hotelierik-turistik	3	15	20
$\Sigma$			<b>51</b>	<b>247</b>	<b>344</b>

## **5. Analiza dhe interpretimi i rezultateve të hulumtimit**

Analiza dhe interpretimi i rezultateve të hulumtimit janë bazuar në perceptimet e menaxhmentit, kuadrit arsimor dhe nxënësve të ShMP-ve, punëdhënësve, vetëqeverisjes lokale, personave të papunësuar dhe përfaqësuesve të institucioneve kompetente për AMP në raport me ndjekjen e daljes, përkatësisht, destinacioneve të nxënësve që kanë përfunduar shkollën.

Analiza e bazuar në përpunimin dhe interpretimin e mëvetësishëm të rezultateve të pohimeve të të anketuarve për çdo pyetje të instrumenteve. Gjatë kësaj, deskriptimi i perceptimeve është rezultat i pohimeve individuale dhe institucionale të të anketuarve. Në bazë të treguesve relevantë të qëndrimeve dhe pikëpamjeve të të anketuarve, sinteza e qëndrimeve të përbashkëta sipas çështjeve të caktuarat ngjashme dhe qëndrimeve krahasuese janë dhënë qëndrimet dhe rekomandimet përfundimtare të hulumtimit.

Faktor jashtëzakonisht i rëndësishëm për punën e suksesshme të çdo ShMP-je, kurse nëpërmjet kësaj edhe të arsimit të mesëm profesional është njohja e gjendjeve në raport me lëvizjen e nxënësve pas përfundimit të arsimit në shkollë. Me rëndësi thelbësore është, ku dhe si është përfaqësimi i nxënësve që kanë përfunduar shkollën përkundrejt tregut të punës, arsimit të lartë etj.

## **5.1. Perceptimi i menaxhmentit për ndjekjen e destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të procesit arsimor**

Që të mund t'i planifikojë dhe iniciojë menaxhmenti përmirësimet në punën e shkollës duhet të dijë me patjetër se çfarë ndodh me nxënësit e tyre pas përfundimit të shkollës së mesme profesionale.

Perceptimi i menaxhmentit në shkollat: ShMQSh “Vllado Tasevski” – Shkup, ShMET “Mihajlo Pupin” – Shkup, ShMQSh “Pançe Karagjozov” – Shkup, ShMQSh “Llazar tanev” – Shkup, ShMQSh “Maria Kyri Sklodovska” – Shkup, ShMQSh “Cvetan Dimov” – Shkuo, ShMK “Kiro Burnjaz” – Kumanovë, ShMK “Jane Sandanski” – Shtip, ShMK “Gjorçe Petrov” – Kavadarç, ShMK “Kole Nedellkovski” – Veles, ShMK “Gjorgji Naumov” – Manastir, ShMK “Dimitar Vllahov”- Strumicë, ShMK “Gostivar” – Gostivar, ShMK “Riste Ristevski Riçko” – Prilep, ShMK “Mosha Pijade” – Tetovë dhe ShMK “Vllado Pitoshevski” – Ohër, e determinuan gjendjen dhe nevojën e ndjekjes sistematike të destinacioneve, përkatësisht të nxënësve të cilët kanë përfunduar shkollën e mesme.

*Si është perceptimi i menaxhmentit të shkollave të mesme profesionale të përfshira në këtë hulumtim në raport me ndjekjen e destinacioneve të nxënësve pasi ata të kenë përfunduar procesin arsimor në shkollën e mesme?*

Në raport me identifikimin se a e dinë se çfarë ndodh me nxënësit e tyre pas përfundimit të arsimit në shkollë, gjashtë të anketuar prej gjashtë shkollave apo 12% janë deklaruar në mënyrë pohuese, 16 të anketuar prej 10 shkollave apo 31% janë deklaruar në mënyrë negative, kurse 29 të anketuar prej të gjitha 16 shkollave apo 57% kanë deklaruar se dinë shumë pak.

Perceptimi i tillë i menaxhmentit dëshmon se nuk ekzistojnë njohuri për atë se çfarë ndodh me nxënësit e tyre pas përfundimit të arsimit në shkollë, kurse ajo që dinë është mjaft e parëndësishme, përkatësisht e realizuar me kontakte incidente dhe komunikime joformale.


Dëshmi për moskezistencën e njohurive dhe të dhënave se çfarë ndodh me nxënësit pas përfundimit arsimit të mesëm profesional prej tyre, janë edhe përgjigjet e menaxhmentit të dhëna ndaj pyetjes “A ekziston sistem elektronik

(zgjidhje softuerike) për ndjekjen e përkatësisë së nxënësve (të punësuar, të papunësuar, kanë vazhduar arsimin etj.) pas përfundimit të arsimit të tyre në shkollën Tuaj”, për të cilën, të gjithë të anketuarit apo 100% kanë deklaruar se nuk ekziston, që padyshim dëshmon se ndjekja sistematike e destinacioneve, përkatësisht, përkatësia e nxënësve pas përfundimit të shkollës së mesme profesionale nuk ekziston.

Deklaratat e menaxhmentit për atë se si e vlerësojnë nevojën e ekzistencës së sistemit elektronik (zgjidhjes elektronike) për ndjekjen e përkatësisë së nxënësve (të punësuar, të papunësuar, kanë vazhduar me arsimin etj.) pas përfundimit të arsimit të tyre në shkollën e mesme profesione dhe krijimin e bazës së të dhënave për to është si vijon:

- për opsionin “nuk është e nevojshme” është shprehur një i anketuar apo 2% e numrit të përgjithshëm të të anketuarve;
- për opsionin “është pak e nevojshme” janë shprehur pesë të anketuar prej 4 shkollave, apo 9% e numrit të përgjithshëm të të anketuarve
- për opsionin “është e nevojshme” janë shprehur 26 të anketuar prej 13 shkollave, apo 51% e numrit të përgjithshëm të të anketuarve;
- për opsionin “është shumë e nevojshme” janë shprehur shtatë të anketuar prej gjashtë shkollave, apo 14% e numrit të përgjithshëm të të anketuarve; dhe
- për opsionin “është e domosdoshme” janë shprehur 12 të anketuar prej 10 shkollave, apo 24% e numrit të përgjithshëm të të anketuarve.

Sinteza e rezultateve dëshmon se nevoja për ekzistencën e sistemit elektronik për ndjekjen e destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të arsimit të tyre në ShMP dhe krijimi i bazës së të dhënave për ta në pjesën më të madhe është në spektrin “është e nevojshme” dhe “është e domosdoshme”, siç tregohet në Grafikon 1, gjatë kësaj, rezultatet flasin për nevojën e padyshimtë të ekzistencës së ndjekjes sistematike të lëvizjes dhe destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të AMP-së prej tyre.



**Grafiku 1**

Duke e theksuar nevojën e ndjekjes sistematike të destinacioneve të nxënësve që kanë përfunduar shkollën, menaxhmenti i shkollave thotë se ndjekja e tillë do të kontribuojë në: krijim më të mirë të politikës së regjistrimit e cila do të bazohet në të dhëna relevante, njohuri të argumentuara për atë se ku kanë përfunduar nxënësit të cilët mund të ndikojnë në projektimin e orientimit profesional dhe zhvillimit të karrierës së gjeneratave të ardhshme të shkollave, lidhjen e zmadhuar midis arsimit dhe tregut të punës, zhvillimin e degëve të nevojshme dhe profileve arsimore në përputhje me tregun e punës, krahasimin e rezultateve që arrihen në shkollë në raport me rezultatet të cilat i dëshmojnë nxënësit pasi të jenë larguar, përkatësisht pasi të kenë përfunduar shkollën e mesme profesionale, hapjen e mundësive për evalvim dhe vetevalvim të punës së shkollës, validitetin e rezultateve të arritura etj.

Në përputhje me hulumtimet e tilla, pyetjes “A konsideroni se sistemi për ndjekjen e përkatësisë së nxënësve mund ta ndryshojë politikën e regjistrimit në nivel të shkollës?”, 36 të të anketuarve apo 70% prej gjashtëmbëdhjetë shkollave i janë përgjigjur pozitivisht, dy të anketuar prej dy shkollave i janë përgjigjur

negativisht, apo 4% e numrit të përgjithshëm të të anketuarve dhe 13 të anketuar prej 9 shkollave apo 26% i janë përgjigjur se ndoshta sistemi i tillë do ta ndryshonte politikën në nivelin e shkollës.


Deklaratat e menaxhmentit në raport me pyetjen “a jeni të gatshëm si shkolla të merrni pjesë në ndërtimin e sistemit për ndjekje gjithëpërfshirëse të shkollës së mesme profesionale” janë si vijon: 39 të anketuar apo 76% të të gjitha gjashtëmbëdhjetë shkollave janë shprehur pozitivisht, 10 të anketuar apo 20% prej shtatë shkollash janë shprehur pozitivisht nëse janë të obliguar për këtë gjë, kurse dy të anketuar prej dy shkollash apo 4% janë shprehur negativisht. Rezultatet flasin për vetëdijen e madhe mbi nevojën e ekzistencës së sistemit të ndjekjes së shkollës së mesme profesionale, kurse nëpërmjet kësaj edhe për gaditshmërinë e lartë të menaxhmentit që shkollat të marrin pjesë në ndërtimin e një sistemi për ndjekje gjithëpërfshirëse të shkollës së mesme profesionale.

Perceptimi i menaxhmentit për atë se kush do të duhej të kujdesej për ndjekjen gjithëpërfshirëse të arsimit të mesëm profesional dhe ta plotësojë bazën e të dhënave në vetë shkollën është si vijon:

- për opsionin “person i trajnuar nga radhët e arsimtarëve” nuk u shpreh asnjë i anketuar;
- për opsionin “person i trajnuar nga radhët e shërbimit pedagogjik-psikologjik” u shprehën pesë të anketuar prej tri shkollash apo 9% e numrit të përgjithshëm të të anketuarve;
- për opsionin “person i posaçëm i trajnuar për punë me bazën e të dhënave dhe kompetencave informatike” u shprehën 21 të anketuar prej 10 shkollash apo 41% e numrit të përgjithshëm të të anketuarve ; dhe
- për opsionin “shërbim i veçantë me përbërje heterogjene (arsimtar, pedagog, psikolog, informaticien)” u shprehën 25 të anketuar prej dymbëdhjetë shkollash apo 50% e numrit të përgjithshëm të të anketuarve.

Spektri analitik i perceptimit të menaxhmentit për atë se kush duhet të kujdeset për ndjekjen gjithëpërfshirëse të arsimit të mesëm profesional dhe kush duhet ta plotësojë bazën e të dhënave në shkollë flet se zgjidhje optimale do të ishte vendosja e një shërbimi të veçantë me përbërje heterogjene e cila do të

kujdesej për bazat e të dhënave dhe vendosjen e tyre analitike dhe përdorim në përputhje me nevojat arsimore. Grafiku 2 e jep perceptimin e menaxhmentit për atë se kush do të duhej ta menaxhonte bazën e të dhënave për ndjekje sistematike të destinacioneve të nxënësve që kanë mbaruar shkollën.



**Grafiku 2**

Identifikimi i menaxhmentit të ShMP për institucionet dhe prioritetin e tyre që të përfshihen gjatë vendosjes së sistemit për ndjekje të arsimit të mesëm profesional nga ana e menaxhmentit është dhënë në Tabelën 4.

Kuantifikimi i perceptimit të shprehur në përqindje për nevojën e përfshirjes së një institucion të caktuar në raport me tri kategori të përfshirjes: “duhet të përfshihet me patjetër”, “është e dëshirueshme të përfshihet” dhe “nuk duhet të përfshihet me patjetër”.

<b>Tabela 4. Kuantifikimi i përfshirjes institucionale për ndjekjen sistematike të arsimit të mesëm profesional i shprehur nga menaxhmenti i ShMP-së</b>				
Nr. rend or	Institucioni	Duhet të përfshihet me patjetër (shprehur në %)	Është e dëshirueshme të përfshihet (shprehur në %)	Nuk duhet të përfshihet me patjetër (shprehur në %)
1.	Shkollat e mesme profesionale (ShMP)	86	14	0
2.	Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH)	78	20	2
3.	Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim (QAPT)	92	8	0
4.	Byroja për Zhvillim të Arsimit (BZhA)	40	50	10
5.	Qendra Shtetërore e Kontrollit (QShK)	25	25	50
6.	Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë (APRM)	66	32	2
7.	Universitete	33	55	12
8.	Bashkësia e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale (BNjVL)	27	55	18
9.	Inspektorati Shtetëror Arsimor (IShA)	23	20	57

Në përputhje me deklaratat e menaxhmentit për përfshirjen e institucioneve gjatë vendosjes së sistemit për ndjekjen e arsimit të mesëm profesional, kurse nëpërmjet kësaj edhe për ndjekjen sistematike të destinacioneve përkatësisht,



përkatësisë së nxënësve pasi kanë mbaruar arsimin e mesëm profesional, të dhëna në Tabelën 4, kemi:

- institucione të cilat duhet të përfshihen me patjetër në sistemin e ndjekjes së arsimit të mesëm profesional janë: ShMP-të, QAPT-i, MASH-i, dhe APRM-ja;
- institucione të cilat është e dëshirueshme të përfshihen në ndjekjen sistematike të arsimit të mesëm profesional janë: Universitetet, BNJVL-ja dhe BZhA-ja; dhe
- institucione të cilat nuk duhet të përfshihen me patjetër në ndjekjen sistematike të arsimit të mesëm profesional janë: QKSh-ja dhe IShA-ja.

Deklaratat e menaxhmentit për pyetjen “A posedoni pajisje teknike-teknologjike (informatika) për vendosjen dhe ndjekjen e bazës së të dhënave në raport me nxënësit që kanë mbaruar shkollën?”, janë: 32 të anketuar prej 14 shkollave apo 63% janë shprehur me “Po”, tri të anketuar prej dy shkollash apo 6% janë shprehur me “Jo”, kurse 16 të anketuar prej nëntë shkollave apo 31% janë shprehur se pajisja të cilën e kanë është e pamjaftueshme.


Perceptimi i tillë i menaxhmentit flet dhe vërteton se pajisja e shkollave me IT është në nivel të kënaqshëm, por në perspektivë ajo duhet të rinovohet.

Deklaratat e menaxhmentit në lidhje me pyetjet:

- “Si menaxher i shkollës a Ju ka vizatuar në tri vitet e fundit punëdhënësi dhe a Ju ka kërkuar nxënës që kanë përfunduar arsimin për punësim”, janë: 20 të anketuar prej 11 shkollave apo 39% janë përgjigjur me “Po”, kurse 31 prej të anketuarve prej 14 shkollave apo 61% janë përgjigjur me “Jo”;
- “Si menaxher i shkollës a Ju kanë vizatuar në tri vitet e fundit përfaqësuesit e arsimit të lartë dhe a Ju kanë konsultuar për nxënës që kanë përfunduar arsimin për krijim të politikës së tyre arsimore” janë: 21 të anketuar prej 13 shkollave apo 41% janë përgjigjur me “Po”, kurse 30 prej të anketuarve prej 15 shkollave apo 59% janë përgjigjur me “Jo”; dhe
- “Si menaxher i shkollës a Ju kanë vizatuar në tri vitet e fundit përfaqësuesit e Agjencisë së Punësimit për shqyrtim të gjendjeve me të papunësuarve të paraqitur gjatë vitit vijues” janë: 15 të anketuar prej 10 shkollave apo 29% janë përgjigjur me

“Po”, kurse 36 prej të anketuarve prej 16 shkollave apo 71% janë përgjigjur me “Jo”.

Pasqyrimi analitik i perceptimit të menaxhmentit për vizitën prej përfaqësuesve të punëdhënësve, arsimit të lartë dhe APRM-së, që implikon dhe një bashkëpunim të caktuar të shkollave profesionale me subjektet e dhëna, dëshmon se bashkëpunimi është i dobët, i brishtë dhe i pamjaftueshëm dhe me një përqindje më të madhe në konotacion negativ siç është treguar në Grafikon 3.



**Grafiku 3**

Pritjet e menaxhmentit në raport me atë se çfarë ndryshimesh do të ndodhnin në nivel shtetëror me vendosjen e sistemit për ndjekje të përkatësisë së nxënësve (të punësuarve, të papunësuarve, kanë vazhduar me arsimin etj.) pas përfundimit të arsimit të tyre janë: politikë regjistrimi e përmirësuar dhe e arsyeshme në pjesën e profilimit të kuadrit, informim i zmadhuar, kurse nëpërmjet kësaj edhe njohuri më të sakta për lëvizjen e nxënësve që kanë mbaruar shkollimin, lidhje e zmadhuar midis nevojave të arsimit dhe nevojave të tregut të

punës, vendosje e bazave të të dhënave të cilat do të prodhojnë të dhëna relevante, kurse nëpërmjet kësaj do të hapin edhe mundësi për tërheqjen e investimeve në rajone të caktuar në bazë të të dhënave për resurset njerëzore në dispozicion, ndryshime të rrjetit të shkollave profesionale në përputhje me kërkesat e TP-së, ndikim i drejtpërdrejtë/apo indirekt në punësim etj.

Sipas vlerësimit të menaxhmentit në ShMIP se cili do të ishte problemi më i madh gjatë vendosjes së sistemit për ndjekje të destinacioneve të nxënësve që kanë mbaruar arsimin, gjatë rangimit nga një deri në gjashtë, ku me një vlerësohet problemi më i madh, kurse me gjashtë problemi më i vogël, pa dyshim si problem më i madh theksohen mjetet financiare dhe resurset njerëzore të patrajnuara, pastaj vijojnë cilësia e pamjaftueshme e pajisjes dhe mungesa e kuantitetit të resurseve njerëzore dhe në fund si problem më i vogël konsiderohen kuantiteti i pajisjes dhe kushtet e pamjaftueshme hapësinore. Skema i rangimit të menaxhmentit në raport me problemet e mundshme gjatë vendosjes së sistemit të ndjekjes së destinacioneve të nxënësve që kanë mbaruar shkollën është dhënë në Grafikon 4.



**Grafiku 4**

## **5.2. Perceptimi i kuadrit arsimor për ndjekjen e destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të procesit arsimor**

Kuadri arsimor është pjesëmarrës direkt në dhënien e njohurive, pasurimin e shkathtësive dhe zbulimin e aftësive të nxënësit gjatë procesit arsimor. Me rëndësi të jashtëzakonshme për vlerësim të cilësisë së punës së kuadrit arsimor dhe ngritjen e vetëdijes për rolin e tij fundamental në procesin e arsimit është ku dhe si është përkatësia, përkatësisht, destinacionet e nxënësve që kanë përfunduar shkollën në përputhje me kompetencat e fituara në shkollën e mesme profesionale përkundrejt tregut të punës, arsimit të lartë apo ndonjë opsioni tjetër.

Perceptimi i kuadrit arsimor të shkollave: ShMQSh “Vllado Tasevski” – Shkup, ShMET “Mihajlo Pupin” – Shkup, ShMQSh “Pançe Karagjozov” – Shkup, ShMQSh “Llazar Tanev” – Shkup, ShMQSh “Maria Kyri Skllodovska” – Shkup, ShMQSh “Cvetan Dimov” – Shkup, ShMK “Kiro Burnjaz” – Kumanovë, ShMK “Jane Sandanski” – Shtip, ShMK “Gjorçe Petrov” – Kavadarç, ShMK “Kole Nedellkovski” – Veles, ShMK “Gjorgji Naumov” – Manastir, ShMK “Dimitar Vllahov”- Strumicë, ShMK “Gostivar” – Gostivar, ShMK “Riste Ristevski Riçko” – Prilep, ShMK “Mosha Pijade” – Tetovë dhe ShMK “Vllado Pitoshevski” – Ohër, e përcakton gjendjen dhe nevojën për ndjekjen sistematike të destinacioneve, përkatësisht, përkatësisë së nxënësve pasi kanë mbaruar shkollën e mesme.

*Si është perceptimi i kuadrit arsimor të shkollave të mesme profesionale të përfshira në hulumtim në raport me ndjekjen e destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të procesit arsimor në shkollat profesionale?*

Në raport me identifikimin se a dinë se çfarë ndodh me nxënësit e tyre pas përfundimit të arsimit në shkollë, 32 të anketuar prej dymbëdhjetë shkolla apo 13% janë shprehur pozitivisht, 71 të anketuar prej të gjitha gjashtëmbëdhjetë shkollave ose 29% janë shprehur negativisht, kurse 144 të anketuar prej të gjitha gjashtëmbëdhjetë shkollave ose 58% janë shprehur se dinë shumë pak.

Perceptimi i tillë i kuadrit arsimor tregon se nuk kanë njohuri se çfarë ndodh me nxënësit e tyre pas përfundimit të arsimit në shkollë, kurse ajo që dinë është mjaft e vogël, e parëndësishme, përkatësisht e realizuar me: kontakte të

rastësishme, komunikime joformale dhe të rastësishme, kontakte nëpërmjet rrjeteve sociale, takimeve jubilarë etj.


Vërtetim për mungesë të njohurive dhe të dhënave se çfarë ndodh me nxënësit pas përfundimit të AMP-së janë edhe përgjigjet e kuadrit arsimor të dhëna për pyetje “A ekziston sistem elektronik (zgjidhje softuerike) për ndjekjen e përkatësisë së nxënësve (të punësuar, të papunësuar, kanë vazhduar me arsimin etj.) pas përfundimit të arsimit të tyre në shkollat Tuaja”, ku të gjithë 247 të anketuarit apo 100% janë shprehur se nuk ekziston, që padyshim flet se sistemi i ndjekjes së destinacioneve, përkatësisht, përkatësia e nxënësve pas përfundimit të shkollës së mesme profesionale nuk ekziston.

Deklaratat e kuadrit arsimor se si e vlerësojnë nevojën për ekzistimin e sistemit elektronik (zgjidhjes softuerike) për ndjekjen e përkatësisë së nxënësve (të punësuar, të papunësuar, kanë vazhduar arsimin etj.) pas përfundimit të arsimit të tyre në shkollat e mesme profesionale dhe krijimin e bazave të të dhënave për ta është si vijon:

- për opsioni “nuk është e nevojshme” janë shprehur 15 të të anketuarve prej gjashtë shkollash apo 6% e numrit të përgjithshëm të të anketuarve;
- për opsioni “është pak e nevojshme” janë shprehur 30 të të anketuarve prej 12 shkollave apo 12% e numrit të përgjithshëm të të anketuarve
- për opsioni “është e nevojshme” janë shprehur 110 të të anketuarve prej të gjitha 16 shkollave apo 44% e numrit të përgjithshëm të të anketuarve;
- për opsioni “është shumë e nevojshme” janë shprehur 55 të të anketuarve prej të gjitha 16 shkollave apo 22% e numrit të përgjithshëm të të anketuarve; dhe
- për opsioni “është e domosdoshme” janë shprehur 37 të të anketuarve prej 13 shkollave apo 16% e numrit të përgjithshëm të të anketuarve.

Sinteza e rezultateve dëshmon për nevojën e ekzistencës së sistemit elektronik (zgjidhjes softuerike) për ndjekjen e përkatësisë së nxënësve (të punësuar, të papunësuar, kanë vazhduar arsimin etj.), pas përfundimit të arsimit të tyre në shkollën e mesme profesionale dhe krijimi i bazës së të dhënave për ta kryesisht është në spektrin “është e nevojshme” dhe “është e domosdoshme”, siç

është treguar më poshtë në Grafikon 5, kështu që nga rezultatet bie në sy nevoja e padiskutueshme e ekzistencës së ndjekjes sistematike të lëvizjes, përkatësisht, destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të arsimit të tyre të mesëm profesional.



**Grafiku 5**

Arsimtarët konsiderojnë se të dhënat të cilat do të dalin nga ndjekja sistematike e destinacioneve të nxënësve që kanë përfunduar shkollë do të mundësojnë: funksion të përmirësuar në mësimdhënien që ata e realizojnë, zhvillim përkatës të degëve dhe profileve arsimore, zgjedhje përkatëse të degëve dhe profileve për gjeneratat e ardhshme, numër të zmadhuar të indikatorëve të suksesit, përkatësisht cilësisë së arsimit, futje objektive të programeve të reja arsimore, ndjekje të arritjeve dhe nxënësve të vet si rezultat i njohurive dhe kompetencave të cilat ua kanë dhënë ata, shkëmbim të përvojave të përbashkëta, kënaqësi personal, mbikëqyrje në cilësinë e kuadrit që prodhon shkolla, marrje e indikatorëve për ndryshim të strategjive edukuese-arsimore në shkollë, ndryshime në politikën e regjistrimit etj.

Përgjigjet e arsimtarëve në raport me pyetjet:


- “si arsimtar a jeni të përgatitur të merrni pjesë në ndërtimin e sistemit të ndjekjes të nxënësve që kanë përfunduar në shkollën Tuaj profesionale”, janë: 201 të anketuar prej të gjitha 16 shkollat apo 81% janë përgjigjur me “Po”, kurse 46 të anketuar nga 11 shkolla apo 19% janë përgjigjur me “Jo”;
- “si arsimtar a do të kujdeseshit për mbushjen e bazës së të dhënave për shkollën Tuaj”, janë: 204 të anketuar prej të gjitha 16 shkollat apo 83% janë përgjigjur me “Po”, kurse 43 të anketuar nga 11 shkolla apo 17% janë përgjigjur me “Jo”.

Perceptimi i tillë i arsimtarëve flet për vetëdijen e lartë mbi nevojën e ndjekjes sistematike të destinacioneve të nxënësve që kanë mbaruar shkollë dhe motivimin e tyre të madh për të marrë pjesë në vendosjen dhe mirëmbajtjen e sistemit për ndjekje të destinacioneve/përkatësisë së nxënësve që kanë mbaruar shkollën.

Përgjigjet e arsimtarëve në lidhje me pyetjen “a posedoni pajisje teknike-teknologjike (informatike) për vendosjen dhe ndjekjen e bazës së të dhënave në raport me nxënësit që kanë përfunduar shkollën”, janë: 114 të anketuar prej 16 shkollave gjithsej apo 46% janë përgjigjur me “Po”, 47 të anketuar prej 11 shkollave apo 19% janë përgjigjur me “Jo”, kurse 86 të anketuar prej të gjitha 16 shkollave apo 35% janë përgjigjur se pajisja të cilën e posedojnë është e pamjaftueshme.

Perceptimi i tillë i arsimtarëve dëshmon dhe vërteton se pajisja e shkollave me IT është në nivel të kënaqshëm, por në perspektivë ajo duhet të rinovohet.

Deklaratat e arsimtarëve në lidhje me pyetjen “si arsimtar deri më sot, a keni pasur ndonjë nevojë për identifikim të nxënësve që kanë mbaruar në shkollën Tuaj”, janë: 84 të anketuar prej të gjitha 16 shkollave apo 34% janë përgjigjur me “Po”, 83 të anketuar prej 14 shkollave apo 34% janë përgjigjur me “Jo”, kurse 80 të anketuar prej të gjitha 16 shkollat apo 32% janë përgjigjur se rrallë kanë pasur nevojë për të dhëna për nxënësit që kanë përfunduar shkollën. Grafiku 6 na jep perceptimin e arsimtarëve në lidhje me nevojën e përkatësisë së nxënësve që kanë përfunduar shkollën.



**Grafiku 6**

Perceptimi i tillë dëshmon dhe vërteton se edhe në punën e deritanishme kanë pasur nevojë për të dhëna dhe njohuri për destinacionet e nxënësve të tyre pas përfundimit të shkollës.

Në përputhje me deklaratat e arsimtarëve, nevoja për të dhëna dhe njohuri për destinacionet e nxënësve të tyre që kanë mbaruar shkollën kanë pasur për shkak të: organizimit të arsimit me përfshirje direkte të nxënësve të mëparshëm të suksesshëm si motivues për gjeneratat ekzistuese, validitetit të punës së vet, marrjes së indikatorëve për qëndrueshmëri dhe zhvillim të degëve dhe profileve në të, zgjidhjes së problemeve profesionale, organizimit të jubilarëve, përfshirjes sociale të grupeve të lëndueshme të nxënësve etj.

Përgjigjet e arsimtarëve në lidhje me pyetjen “a keni Ju bazë personale statistike të të dhënave për nxënësit për të cilët keni qenë mësues kujdestar”, janë: 13 të anketuar nga gjashtë shkolla apo 5% janë përgjigjur me “Po”, 234 të anketuar nga të 16 shkollat apo 95% janë përgjigjur me “Jo”.

Perceptimi i tillë i arsimtarëve për bazën individuale statistikore të të dhënave për nxënësit që kanë mbaruar shkollën për të cilët kanë qenë mësues kujdestarë dëshmon se nuk e posedojnë, përkatësisht nuk ekziston, kurse ajo për



të cilën disa thonë se e kanë është evidencë e mbajtur me shkrim e cila nuk është e tërësishme, kurse nëpërmjet kësaj edhe e papërshtatshme.

Duke kryer sintezë të fitimeve të dhëna të cilat arsimtarët i thonë mbi ndjekjen sistematike të nxënësve që kanë mbaruar arsimin profesional mund t'i veçojmë: mbikëqyrje objektive në cilësinë e punës së arsimtarëve, motivim për angazhim më të madh, planifikim i përmirësuar i regjistrimit në shkollat e mesme profesionale dhe në fakultete, përforsim i lidhjes midis arsimit dhe TP-së, tregues relevantë mbi suksesin, përkatësisht, moskëmbësishmësinë e arsimtarit në profilimin e kuadrit, promovim i arsimtarëve të mirë, zmadhim i mundësive për organizim të debateve të nxënësve të mëparshëm me ata të tanishmit me qëllim që të kihet mbikëqyrje e drejtë në të gjitha lehtësimet që u janë ofruar nxënësve në arsim, drejtim më i mirë i gjeneratave të ardhshme, ndryshime përkatëse në rrjetin e shkollave profesionale, degëve dhe profileve arsimore, përmirësim i imixhit të shkollave, ndërtim i rrjetit të komunikimit, ndikim mbi punën e kuadrove, zmadhim i interesit për arsimin profesional, informim i zmadhuar, rritje e vetëbesimit.

Kuadri mësimdhënës, nuk thekson ndonjë sugjerim dhe propozim të veçantë në lidhje me ndërtimin e sistemit/modelit për ndjekjen e nxënësve që mbaruar shkollë, përveç se, ndjekja sistematike duhet të jetë gjithëpërfshirëse, të ekzistojnë baza të unifikuara të të dhënave dhe të ekzistojnë sjellje interaktive midis institucioneve të AMP-së, TP-së dhe arsimit të lartë.

### **5.3. Perceptimi i nxënësve për ndjekjen e destinacioneve të tyre pas përfundimit të procesit arsimor në shkollat profesionale**

Faktor kryesor për vendosjen e ndjekjes sistematike të destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të procesit arsimor në shkollë janë vetë nxënësit. Komponentë shumë të rëndësishëm janë niveli i zhvillimit të kompetencave të nxënësve dhe vetëdija mbi nevojën e ndjekjes sistematike të destinacioneve të tyre pas përfundimit të procesit arsimor dhe daljes nga shkolla profesionale.

Perceptimi i nxënësve të vitit të katër përfundimtar në: ShMQSh “Vllado Tasevski” – Shkup, ShMET “Mihajlo Pupin” – Shkup, ShMQSh “Pançe Karagjozov” – Shkup, ShMQSh “Llazar Tanev” – Shkup, ShMQSh “Maria Kyri Skllodovska” – Shkup, ShMQSh “Cvetan Dimov” – Shkup, ShMK “Kiro Burnjaz” – Kumanovë, ShMK “Jane Sandanski” – Shtip, ShMK “Gjorçe Petrov” – Kavadarç, ShMK “Kole Nedellkovski” – Veles, ShMK “Gjorgji Naumov” – Manastir, ShMK “Dimitar Vllahov”- Strumicë, ShMK “Gostivar” – Gostivar, ShMK “Riste Ristevski Riçko” – Prilep, ShMK “Mosha Pijade” – Tetovë dhe ShMK “Vllado Pitoshevski” – Ohër, e përcakton gjendjen dhe nevojën për ndjekjen sistematike të destinacioneve, përkatësisht, përkatësisë e tyre pas përfundimit të shkollës së mesme.

*Si është perceptimi i kuadrit nxënësve të shkollave të mesme profesionale të përfshirë në hulumtim në raport me ndjekjen e destinacioneve të tyre pas përfundimit të procesit arsimor në ShMP?*

Në lidhje me pyetjen “A Ju zbulon shkolla mundësitë se ku mund të vazhdoni karrierën Tuaj (punësim, Arsim i lartë, trajnime të ndryshme etj.) pas përfundimit të arsimit të mesëm”, 122 të anketuar nga të gjitha 16 shkollat apo 35% janë përgjigjur pozitivisht, 120 të anketuar nga të gjitha 15 shkollat apo 35% janë përgjigjur negativisht, kurse 102 të anketuar nga të gjitha 16 shkollat apo 30% janë përgjigjur për mundësinë se shkolla u jep shumë pak drejtime ku ta vijojnë karrierën e vet.

Perceptimi i tillë i nxënësve dëshmon se nuk ekziston, apo nëse ekziston drejtim i nxënësve se ku të vazhdojnë pas përfundimit të AMP-së është shumë e dobët dhe me karakter jokonzistent.

Përgjigjet e nxënësve për pyetjen “a posedon shkolla teknologji informatike (IT) e cila mundëson shfrytëzimin e internetit” janë: 248 të anketuar nga 15 shkolla apo 72% janë përgjigjur me “Po”, 36 të anketuar nga shtatë shkolla apo 10% janë përgjigjur me “Jo” dhe 60 të anketuar nga 15 shkolla apo 18% janë përgjigjur me opsionin “shumë pak”.

Perceptimi i tillë i nxënësve dëshmon dhe vërteton se pajisja e shkollave me TI është në nivel të kënaqshëm, por në perspektivë ajo duhet të rinovohet.

Identifikimi i nxënësve i cili mund të shfrytëzojë pajisjen informatike në shkollë është si vijon:

- për opsionin “nuk lejohet të përdoret për askënd” janë shprehur 12 të anketuar nga tri shkolla apo 4% e numrit të përgjithshëm të të anketuarve;
- për opsionin “mund ta përdorin vetëm arsimtarët” janë shprehur 25 të anketuar nga 10 shkolla apo 7% e numrit të përgjithshëm të të anketuarve;
- për opsionin “nxënësit mund ta përdorin vetëm gjatë mësimit në prani të arsimtarit, kurse arsimtarët mundet edhe më tepër, përkatësisht, edhe jashtë mësimit” janë shprehur 175 të anketuar nga të gjitha 16 shkollat apo 51% e numrit të përgjithshëm të të anketuarve; dhe
- për opsionin “në mënyrë të barabartë mund ta përdorin edhe arsimtarët edhe nxënësit si në mësim ashtu edhe jashtë tij” janë shprehur 132 të anketuar nga të gjitha 16 shkollat apo 38% e numrit të përgjithshëm të të anketuarve.

Si rrjedhim i perceptimit për atë se kush mund ta shfrytëzojë TI në shkollë është perceptimi i nxënësve për se shfrytëzohet ajo më shpesh. Kështu që, 140 të anketuar nga të gjitha 16 shkollat apo 40% kanë thënë “për realizim të mësimit”, 148 të anketuar prej 16 shkollave apo 43% kanë thënë “për të kërkuar në internet”, 15 të anketuar nga shtatë shkolla apo 4% kanë thënë “për nevojat e veta e shfrytëzojnë vetëm arsimtarët”, 19 të anketuar nga tetë shkolla apo 6% kanë thënë “nuk përdoret” dhe 22 të anketuar nga 10 shkolla apo 7% kanë thënë se “nuk e dinë” për se përdoret pajisja informatike në shkollë.

Interpretimi i deklaratave të nxënësve se kush mund dhe për se mund të shfrytëzohet pajisja informatike në shkollë, kryesisht rezulton se nxënësit mund ta


përdorin TI vetëm në mësim në prani të arsimit, më shpesh përdoret për kërkim në internet, kurse rastësisht mund ta përdorin edhe jashtë procesit arsimor.

Deklarata e nxënësve në lidhje me pyetjet:

- “a keni kompjuter dhe internet në shtëpi” janë: 317 të anketuar nga të gjitha 16 shkollat apo 92% janë përgjigjur me “Po”, kurse 27 të anketuar nga 10 shkolla apo 8% janë përgjigjur me “Jo”.
- “ku i përdorni më shpesh shërbimet e internetit” janë si më poshtë:
  - me opsionin “nuk përdor internet”, janë përgjigjur 13 të anketuar nga pesë shkolla ose 4%;
  - me opsionin “në shkollë” janë përgjigjur 24 të anketuar nga 11 shkolla ose 7%;
  - me opsionin “në shtëpi” janë përgjigjur 217 të anketuar nga të gjitha 16 shkollat ose 63%;
  - me opsionin “njësoj edhe në shkollë edhe në shtëpi” janë përgjigjur 83 të të anketuarve nga 14 shkolla 24%; dhe
  - me opsionin “në vend tjetër (internet-kafe, kafe-bare, miq, shokë etj.)” janë përgjigjur shtatë të anketuar nga pesë shkolla ose 2%.
- “a keni adresë personale të postës elektronike (e-mail)” 318 të anketuar nga të gjitha shkollat apo 92% janë shprehur se kanë postën e vet elektronike, kurse 26 të anketuar nga shtatë shkolla apo 8% janë shprehur se nuk kanë adresën e vet elektronike.

Gjatë sintezës së të dhënave nga pyetjet për posedim të kompjuterit dhe internetit në kushte shtëpiake, vendin e shfrytëzimit të shërbimeve në internet dhe posedimin e adresës personale elektronike mund të nxirret përfundimi se 92% e nxënësve kanë kompjuterin e vet, përdorin internet dhe kanë adresën e vet elektronike, që do të thotë se janë në gjendje të komunikojnë në mënyrë elektronike, kurse 8% e nxënësve nuk përdorin shërbime interneti dhe nuk kanë adresën e vet elektronike, që do të thotë se nuk janë në gjendje të komunikojnë në mënyrë elektronike.

Gjendja mbi komunikimin e mundshëm elektronik të nxënësve është dhënë në Grafikon 7.



**Grafiku 7**

Perceptimet e mëposhtme të nxënësve janë në drejtim të shpjegimit të pikëpamjeve dhe qëndrimeve të tyre në raport me ndjekjen e përkatësisë së tyre pas përfundimit të arsimit të mesëm profesional.


Në lidhje me pyetjen se “a do të dëshironin të qëndronin në komunikim me shkollën pasi të kenë përfunduar arsimin e mesëm profesional”, 289 të anketuar nga të gjitha 16 shkollat ose 84% janë shprehur se do të dëshironin, kurse 55 të të anketuarve nga të gjitha 16 shkollat ose 16% nuk do të dëshironin të mbeten në komunikim me shkollën pas përfundimit të AMP-së.

Si rrjedhim i perceptimit të nxënësve se a do të dëshironin të mbeten në komunikim me shkollën pasi të përfundojë AMP-në është perceptimi i tyre në lidhje me pyetjen “a do të ishin të gatshëm (a do të mundni) me kërkesë të shkollës pas përfundimit të AMP-së t’i japin informacione shkollës të paktën një herë në vit për destinacionet e tyre (informacione të llojit: a jeni i papunësuar, a jeni i punësuar dhe ku; a jeni në arsim të lartë dhe ku etj.)”. Kështu 286 të anketuar nga të gjitha 16 shkollat apo 83% janë shprehur pozitivisht, kurse 58 të anketuar nga 12 shkolla apo 17% janë shprehur negativisht.

Shkaqet të cilat jepen nga nxënësit të cilët nuk do të dëshironin të mbeten në komunikim dhe nuk janë të gatshëm t’i japin informacione për destinacionet shkollës pas përfundimit të AMP-së janë:

- nuk shihet nevoja dhe arsyeja që të mbeten në komunikim dhe t'i japin informacione për destinacionet e tyre shkollës;
- motivim i pamjaftueshëm që të mbeten në komunikim me shkollën;
- mungesa e inventivitetit për komunikim të mëtejshëm me shkollën;
- ndjenjë e keqe të cilën e mbartin për shkak të raportit joprofesional me një pjesë kuadrit arsimtar;
- shkolla nuk ka ndërtuar ndjenjë të mjaftueshme të përkatësisë dhe kujdesit tek një pjesë e nxënësve gjatë arsimit katërvjeçar;
- komunikim i keq në relacionin arsimtar-nxënës; dhe
- largim nga Republika e Maqedonisë për vazhdim të arsimit dhe ndryshim të vendit të jetesës.

Pasqyrimi analitik i perceptimeve të nxënësve të cilët duan dhe mund të mbeten në komunikim me shkollën pas përfundimit të arsimit të mesëm profesional tregon një përqindje të lartë prej 83%, që është një parakusht i mirë për vendosjen e ndjekjes sistematike të nxënësve pas përfundimit të AMP-së. Raporti i nxënësve që dëshirojnë dhe të cilët mund të mbeten në komunikim me shkollën dhe të atyre që nuk duan dhe nuk mund të mbeten në komunikim me shkollën pas përfundimit të arsimit të mesëm profesional tregohet në Grafikon 8.



**Grafiku 8**

Pikëpamjet e nxënësve për periudhën kohore që është e mjaftueshme që të ndiqen destinacionet e tyre janë: për periudhë deri në pesë vjet janë shprehur 229 të anketuar nga të gjitha 16 shkollat ose 67%, për periudhë nga pesë deri në shtatë vjet janë shprehur 72 të anketuar nga 15 shkolla ose 21% dhe për periudhë mbi shtatë vjet janë shprehur 43 të anketuar nga 13 shkolla ose 12%.

Në përputhje me vlerësimet e nxënësve periudha kohore prej pesë vjetësh pas përfundimit të arsimit të mesëm profesional është optimale për dhënien e informacioneve dhe ndjekjen sistematike të destinacioneve të tyre.

Perceptimi i nxënësve se a shohin fitim personal me dhënien e informacioneve shkollës për destinacionet e tyre pas përfundimit të AMP-së (informacione të llojit: a jeni i papunësuar, a jeni i punësuar dhe ku; a jeni në arsim të lartë dhe ku etj.), është se 227 të anketuar nga të gjitha 16 shkollat ose 66% shohin fitim personal, kurse 117 të anketuar nga të gjitha 16 shkollat ose 34% nuk shohin fitim personal me dhënien e informacioneve shkollës për destinacionet e tyre.


Fitimet të cilat i theksojnë nxënësit nga dhënia e informacioneve shkollës (informacione të llojit: a jeni i papunësuar, a jeni i punësuar dhe ku; a jeni në arsim të lartë dhe ku etj.) dhe ekzistimi i ndjekjes sistematike të destinacioneve të tyre pas përfundimit të arsimit të mesëm profesional janë:

- ndihmë dhe dhënie informacione për punësimet e ardhshme të mundshme;
- marrje informacionesh dhe këshillash për gjendjet në raport me tregun e punës dhe arsimin e lartë;
- zhvillim i ndjenjës së sigurisë për shkak të ekzistencës së institucionit tek i cili mund të drejtohen për çdo lloj problemi;
- ndërtim i marrëdhënieve partnere të bashkëpunimit me shkollën;
- marrje të rekomandimeve për punëdhënësit e ardhshëm; dhe
- mundësi për shfrytëzim të resurseve (pajisjeve) të shkollës.

perceptimi i nxënësve për mënyrën më të përshtatshme të komunikimit dhe dhënies së informacioneve në shkollë (informacione të llojit: a jeni i papunësuar, a jeni i punësuar dhe ku; a jeni në arsim të lartë dhe ku etj.), është si vijon:

- për opsionin “komunikim nëpërmjet telefonit”, janë shprehur tetë të anketuar prej shtatë shkollash ose 2%;
- për opsionin “komunikim nëpërmjet postës elektronike (e-mail)”, janë shprehur 91 të anketuar nga të gjitha 16 shkollat ose 26%;
- për opsionin “komunikim direkt me vizitë të shkollës”, janë shprehur 131 të anketuar nga të gjitha 16 shkollat ose 38%; dhe
- për opsionin “çfarëdolloj komunikimi”, janë shprehur 114 të anketuar nga të gjitha 16 shkollat ose 33%.

Raporti i perceptimit të nxënësve për mënyrat e ndryshme të komunikimit me shkollën pas përfundimit të AMP-së është dhënë në Grafikon 9.



**Grafiku 9**

Analiza e deklaratave të nxënësve për mënyrën më të përshtatshme të komunikimit dhe dorëzimit të informacioneve në shkollë në lidhje me destinacionet e tyre pas përfundimit të arsimit të mesëm profesional dëshmon se gjatë projektimit dhe vendosjes së ndjekjes sistematike të nxënësve që kanë mbaruar shkollën nevojitet mundësim i komunikimit heterogjen (sintezë e shumë llojeve të komunikimit), kurse jo të një lloji komunikimi.



Sipas deklaratave të nxënësve në lidhje me pyetjen ku do të vazhdojnë pas përfundimit të shkollës së mesme profesionale kemi: 214 të anketuar nga 16 shkolla apo 62% janë shprehur se do të vazhdojnë punën, kurse 60 të anketuar nga 15 shkolla ose 18% janë shprehur se nuk e dinë ku do të vazhdojnë pas përfundimit të AMP-së.


Perceptimi i tillë jep drejtim ku është përkatësia kryesore e nxënësve pas përfundimit të shkollës së mesme profesionale dhe i përcakton institucionet siç janë: shkollat, fakultetet, APRM dhe QAPT të cilët si aktorë kryesorë duhet të involvohen direkt në ndjekjen sistematike të arsimit të mesëm profesional, gjatë kësaj, assesi nuk duhet të anashkalohen nxënësit të cilët nuk dinë ku do të vazhdojnë pas arsimit të mesëm, përkatësisht kategorinë e nxënësve që kanë mbaruar dhe nuk do të fitojnë përkatësi në tregun e punës apo në arsimin e lartë.

Vlerësimi i nxënësve për nevojën e vendosjes së sistemit për ndjekje të destinacioneve të tyre pas përfundimit të arsimit të mesëm profesional me qëllim që të jepet ndihmë e vazhdueshme në zhvillimin e individit është si vijon:

- për opsionin “nuk është e nevojshme” janë shprehur 15 të anketuar nga tetë shkolla ose 4%;
- për opsionin “është e nevojshme” janë shprehur 195 të anketuar nga të gjitha 16 shkollat ose 57%;
- për opsionin “është e domosdoshme” janë shprehur 84 të anketuar nga të gjitha 16 shkollat ose 24%; dhe
- për opsionin “nuk e di” janë shprehur 50 të anketuar nga 14 shkolla ose 15%.

Sinteza e rezultateve dëshmon se nevoja e vendosjes së sistemit të ndjekjes së destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të arsimit të mesëm profesional, kryesisht është në spektrin “është e nevojshme” dhe “është e domosdoshme”, kështu që, rezultatet dëshmojnë nevojën e padyshimtë të ekzistencës së ndjekjes sistematike të dhënë.

Raporti i vlerësimeve të nxënësve për nevojën e sistemit për ndjekje të destinacioneve të tyre pas përfundimit të AMP-së është dhënë në Grafikon 10.



**Grafiku 10**

#### 5.4. Perceptimi i punëdhënësve për ndjekjen e destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të procesit arsimor

Punëdhënësit janë konsumatorët e drejtpërdrejtë të njohurive dhe aftësive të fituara nga nxënësit që kanë përfunduar AMP. Me rëndësi të jashtëzakonshme për vlerësim të cilësisë së fuqisë së punës janë perceptimet e tyre, përkatësisht, roli i tyre aktiv në ndjekjen sistematike të nxënësve që kanë mbaruar shkollën. Informacionet e marra nga punëdhënësit dhe vetëdija e tyre mbi nevojën e të dhënave për përkatësinë, përkatësisht, destinacionet e nxënësve që kanë mbaruar arsimin e mesëm profesional përkundrejt tregut të punës janë faktor i rëndësishëm për funksionimin e suksesshëm të ndjekjes sistematike të nxënësve që kanë mbaruar shkollën.

Perceptimi i punëdhënësve spektri i të cilit është dhënë në Tabelën 2 e përcakton gjendjen dhe nevojën e ndjekjes sistematike të destinacioneve, përkatësisht, përkatësinë e nxënësve pas përfundimit të shkollës së mesme.

<b>Tabela 5: Spektri i punëdhënësve</b>			
<b>NR. RENDOR</b>	<b>KOMPANIA</b>	<b>QYTETI</b>	<b>VEPRIMTARIA</b>
1.	Agroinvest	Shtip	Prodhimtari primare e qumështit
2.	Amorteks	Koçani	Tregti tekstili
3.	Allinad	Koçani	Shërbime me prodhime metali
4.	EvroBallkan	Koçani	Shërbim
5.	Elida Turs	Ohër	Turizëm dhe hotelieri
6.	Via Prom	Ohër	Prodhimtari të prodhimeve konditore
7.	Trend Trejd	Ohër	Tregti dhe shërbime
8.	Koshishta	Ohër	Tregti me prodhime ushqimore
9.	Tekstill-Struga	Strugë	Shërbime me tekstil
10.	Internacional 2	Strugë	Prodhim i prodhimeve të furrës
11.	Impalla	Strugë	Përpunim guri
12.	Kapital media grup	Shkup	Veprimtari botuese
13.	NK "Higjiena komunale"	Shkup	Komunale dhe higjiena
14.	Inbox-Arhivski centar	Shkup	Arkivim
15.	Mobil Porto 3M	Shkup	Tregti
16.	Flloks Km	Shkup	Tregti me pasuri të patundshme
17.	SK mebell	Shkup	Tregti me mobilie
18.	Pingiv Market	Shkup	Tregti
19.	Tabernaku-shtypshkronjë	Shkup	Veprimtari botuese

20.	Hisar Kompani	Shkup	Transport
21.	Zllate Trans	Shkup	Transport
22.	Viza-hotelier	Shkup	Hotelier
23.	Debarca Komerc	Shkup	Tregti
24.	Nixho Komerc	Shkup	Tregti
25.	ALL-MA-DE	Shkup	Prodhimtari dhe tregti
26.	DTGM ADOR STILL	Shkup	Tregti me kozmetikë
27.	DPTU MULLTI MIKS	Shkup	Prodhimtari dhe tregti ushqimi
28.	Propoint-shtypshkronjë	Shkup	Veprimtari botuese

*Si është perceptimi i punëdhënësve të përfshirë në hulumtim në lidhje me ndjekjen e destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të procesit arsimor në shkollën profesionale?*

Në lidhje me pyetjen “a ka në rajonin ku gjendet kompania Juaj shkollë të mesme profesionale e cila prodhon kuadro kompetentë për punësim tek Ju”, 15 të anketuar ose 54% janë shprehur pozitivisht, kurse 13 të anketuar ose 46% janë shprehur negativisht.

Perceptimi i tillë i punëdhënësve dëshmon për praninë gjysmake të shkollës profesionale në rajonin ku gjenden ata, kështu që kjo mund të jetë për shkak të gjendjes faktive apo të mosinformimit të punëdhënësve se ekziston shkollë profesionale në rajonin e tyre.

Deklaratat e punëdhënësve në raport me pyetjet:

- “a bashkëpunojnë me shkollat e rajonit të tyre” janë: një i anketuar ose 4% janë përgjigjur pozitivisht, 21 të anketuar ose 75% janë përgjigjur negativisht, kurse gjashtë të anketuar ose 21% janë shprehur se realizojnë bashkëpunim të pjesshëm; dhe
- “a bashkëpunojnë me cilëndo shkollë në territorin e Republikës së Maqedonisë” janë: një i anketuar ose 4% janë përgjigjur pozitivisht, 20 të anketuar ose 71% janë përgjigjur negativisht, kurse shtatë të anketuar ose 25% janë shprehur se realizojnë bashkëpunim të pjesshëm, përkatësisht të përkohshëm.

Analiza e perceptimit të tillë të punëdhënësve në lidhje me bashkëpunimin me shkollat profesionale dëshmon se nuk ekziston bashkëpunim midis këtyre dy

palëve, kurse edhe nëse ekziston bashkëpunimi, ai realizohet pjesërisht dhe përkohësisht. Në rastet më të shpeshta bashkëpunimi ndodh për shkak të vizitave të rastësishme të shkollave në kompanitë apo për shkak të mbajtjes së mësimit praktik në ato kompani.

Perceptimi i punëdhënësve për bashkëpunimin e realizuar me shkollat e mesme profesionale, jepet në Grafikon 11.



**Grafiku 11**

Dëshmi për bashkëpunimin e dobët midis punëdhënësve dhe shkollave janë edhe përgjigjet të cilat i japin punëdhënësit në lidhje me pyetje “a pranoni në kompaninë tuaj nxënës për trajnim praktik”, kështu pesë të anketuar ose 18% janë përgjigjur me “Po”, 22 të anketuar ose 78% janë përgjigjur me “Jo”, kurse një i anketuar ose 4% dha opsionin “Përkohësisht”.

Si rezultat i bashkëpunimit të dobët midis shkollave dhe punëdhënësve, është normale të pritet se punëdhënësit nuk posedojnë sistem të ndjekjes së përkatësisë së nxënësve që kanë përfunduar shkollën apo për ndjekje të përparimit të tyre, ndërkohë që janë në kompani, kështu deklarata 100% e punëdhënësve se nuk kanë ndjekje sistematike e vërteton konstatimin e tillë.

Në lidhje me pyetjen “a u jepni prioritet nxënësve të cilët realizojnë trajnim praktik në kompaninë Tuaj gjatë punësimit të kuadrove të reja”, 13 të anketuar ose 46% janë përgjigjur pozitivisht, 10 të anketuar ose 36% janë përgjigjur negativisht,

kurse pesë të anketuar ose 18% janë përgjigjur se ndonjëherë u japin përparësi gjatë punësimit nxënësve që kanë qenë dhe kanë realizuar punën praktike në kompani.

Perceptimi i tillë i punëdhënësve dëshmon se ka ndikim mbi punësimin e kuadrove të reja kryerja e mësimit praktik në kompani, kurse ky ndikim do të ishte edhe më i madh nëse bashkëpunimi midis shkollave dhe punëdhënësve zmadhohet, zgjerohet dhe thelësohet.

Deklaratat e punëdhënësve në lidhje me pyetjen “a keni mungesë të kuadrove që kanë përfunduar arsimin e mesëm profesional për nevojat e kompanisë Suaj”, janë: 10 të anketuar ose 36% janë përgjigjur me “Po”, 14 të anketuar ose 50% janë përgjigjur me “Jo”, kurse katër të anketuar ose 14% janë përgjigjur me opsionin “Ndonjëherë”.

Perceptimi i tillë i punëdhënësve dëshmon mbi mungesën gjysmake në fuqinë e punës, kurse plotësimi i nevojës për kuadro të reja më shpesh realizohet me nxjerrjen e shpalljeve, kontakteve personale, marrjen e informacioneve nga APRM-ja dhe nga të punësuarit.

Në lidhje me pyetje “a jeni të përgatitur si kompani të bashkëpunoni me shkollat në krijimin e politikës së regjistrimit në shkollë, përkatësisht, të shprehni nevojën për programin arsimor përkatës për një degë të caktuar”, 15 të anketuar ose 54% janë përgjigjur pozitivisht, tetë të anketuar ose 28% janë përgjigjur negativisht, kurse pesë të anketuar ose 18% janë shprehur se janë pjesërisht të përgatitur për bashkëpunim.

Perceptimi i tillë i punëdhënësve dëshmon se ata janë të hapur për bashkëpunim me shkollat profesionale, ekziston përgatitje, diskonim si edhe nevoja të identifikuar për lidhje të ardhme më të fuqishme me shkollat.

Identike janë edhe deklaratat e punëdhënësve në lidhje me pyetjet: “a mendoni se ekziston nevoja e ndjekjes sistematike të nxënësve që kanë përfunduar AMP-në prej të cilit mund të merrni të informacione për kuadro që kanë përfunduar arsimin profesional, kompetentë për vendet e punës në kompaninë Tuaj” dhe “nëse ekzistonte sistemi i ndjekjes së përkatësisë së nxënësve pas përfundimit të arsimit të tyre, a do ta shfrytëzonit gjatë punësimit të kuadrit të rinj të

nevojshëm”, kështu 23 të anketuar ose 82% janë përgjigjur me “Po”, kurse pesë të anketuar ose 18% me “Jo”.

Spektri analitik i perceptimit të tillë i punëdhënësve dëshmon se ekziston vetëdije e lartë për nevojën e ndjekjes sistematike të nxënësve që kanë përfunduar AMP. Nevojën të cilën e dëshmojnë punëdhënësit është qasje më e lehtë, më e shpejtë dhe më e tërësishme të informacionet për kuadro që kanë përfunduar arsim të mesëm profesional kompetentë për kryerjen punëve dhe detyrave të punës në kompani, si edhe qasje më e shpejtë dhe më lehtësuese të fuqia e punës. Perceptimi i punëdhënësve mbi nevojën e ndjekjes sistematike të nxënësve që kanë përfunduar AMP dhe kuantumi i shfrytëzimit të sistemit të tillë jepet në Grafikon 12.



**Grafiku 12**


Vlerësimi i punëdhënësve mbi nevojën e vendosjes së sistemit të ndjekjes së destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të arsimit të mesëm profesional është si vijon:

- për opsionin “nuk është i nevojshëm” janë shprehur dy të anketuar ose 7%;
- për opsionin “është pak i nevojshëm” janë shprehur tre të anketuar ose 10%;
- për opsionin “është i nevojshëm” janë shprehur 13 të anketuar ose 47% ;

- për opsionin "është shumë i nevojshëm" janë shprehur gjashtë të anketuar ose 22%; dhe
- për opsionin "është i domosdoshëm" janë shprehur katër të anketuar ose 14%;

Sinteza e rezultateve dëshmon se nevoja e vendosjes së sistemit të ndjekjes së destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të arsimit të mesëm profesional, kryesisht është në spektrin e "është i nevojshëm" dhe "është i domosdoshëm" kështu që rezultatet dëshmojnë nevojën e padyshimtë të ekzistimit të sistemit të ndjekjes.

Raporti i vlerësimeve të punëdhënësve mbi nevojat e sistemit për ndjekje të destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të AMP është dhënë Grafikon 13.



**Grafiku 13**

Në lidhje me identifikimin se kush duhet ta kujdeset dhe duhet ta mbushë bazën e të dhënave, perceptimi i punëdhënësve është: 10 punëdhënës ose 36% konsiderojnë se për bazën e të dhënave duhet të kujdesen shkolla, 13 ose 46% konsiderojnë se këtë gjë duhet ta bëjnë komunat, kurse pesë ose 18% konsiderojnë se mirëmbajtja dhe mbushja e bazës së të dhënave duhet të bëhet nga ndonjë institucion tjetër siç janë APRM-ja dhe QAPT-ja.



Perceptimi i tillë i punëdhënësve dëshmon se në mirëmbajtjen dhe mbushjen e bazës së të dhënave duhet të përfshihen shumë institucione me role, pjesëmarrje dhe përgjegjësi të ndarë.

Identifikimi i punëdhënësve në lidhje me institucionet dhe riorientimin e tyre në përfshirje gjatë vendosjes së sistemit për ndjekje sistematike të destinacioneve, përkatësisht, përkatësisë së nxënësve pas përfundimit të arsimit të mesëm profesional është dhënë në Tabelën 6.

Kuantifikimi i perceptimit të shprehur në përqindje për nevojën e përfshirjes së një institucioni konkret është kryer në lidhje me tri kategori të përfshirjes: “duhet të përfshihet me patjetër”, “është e dëshirueshme të përfshihet” dhe “nuk duhet të përfshihet me patjetër”.

<b>Tabela 6. Kuantifikimi i përfshirjes institucionale për ndjekjen sistematike të arsimit të mesëm profesional e shprehur nga punëdhënësit</b>				
Nr. rendor	Institucioni	Duhet të përfshihet me patjetër (deklarata në %)	Është e dëshirueshme të përfshihet (deklarata në %)	Nuk duhet të përfshihet me patjetër (deklarata në %)
1.	Shkolla të mesme profesionale (ShMP)	93	7	0
2.	Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH)	85	11	4
3.	Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim (QAPT)	90	6	4
4.	Byroja për Zhvillim të Arsimit (BZhA)	35	54	11
5.	Qendra Shtetërore e Kontrollit (QShK)	14	22	64
6.	Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë (APRM)	75	25	0
7.	Universitete	18	78	4
8.	Bashkësia e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale (BNjVL)	14	61	25

9.	Inspektorati Shtetëror i Arsimit (ISHA)	14	28	58
----	---	----	----	----

Në përputhje me deklaratat e punëdhënësve për përfshirjen e institucioneve gjatë vendosjes së sistemit për ndjekje sistematike të destinacioneve, përkatësisht, përkatësisë së nxënësve pasi kanë përfunduar arsimin e mesëm profesional, të dhëna në Tabelën 6, kemi:

- institucione të cilat duhet të përfshihen në ndjekjen sistematike të destinacioneve, përkatësisht, përkatësisë së nxënësve pas përfundimit të arsimit të mesëm profesional janë: ShMP, QAPT, MASH dhe APRM;
- institucione të cilat është e dëshirueshme të përfshihen në ndjekjen sistematike, përkatësisht, përkatësisë së nxënësve pas përfundimit të arsimit të mesëm profesional janë: Universitetet, BNjVL-ja dhe BZhA-ja; dhe
- institucione të cilat nuk duhet të përfshihen në ndjekjen sistematike të destinacioneve, përkatësisht, përkatësisë së nxënësve pas përfundimit të arsimit të mesëm profesional janë: QShK dhe IShA .

Perceptimi i tillë i punëdhënësve është pothuajse identik me perceptimin e menaxhmentit të shkollave të mesme profesionale mbi përfshirjen e institucioneve gjatë vendosjes së sistemit për ndjekje sistematike të destinacioneve, përkatësisht, përkatësisë së nxënësve pas përfundimit të arsimit të mesëm profesional.

Sipas vlerësimit të punëdhënësve se cili do të ishte problemi më i madh gjatë vendosjes së sistemit për ndjekje të destinacioneve të nxënësve që kanë përfunduar shkollë, gjatë rangimit nga një deri në gjashtë, ku me njësh përcaktohet problemi më i madh, kurse me gjashtë problemi më i vogël, padyshim si problem më i madh theksohen mjetet e pamjaftueshme financiare dhe resurset njerëzore që nuk janë trajnuar, pastaj vijojnë mungesa e kuantitetit të resurseve njerëzore, kuantiteti i pamjaftueshëm i pajisjes, cilësia e pamjaftueshme e pajisjes dhe në fund për si problem më i vogël konsiderohen kushtet e pamjaftueshme të hapësirës. Skema e rangimit të punëdhënësve në lidhje me problemet e mundshme gjatë vendosjes së sistemit për ndjekje të destinacioneve të nxënësve që kanë përfunduar shkollën është dhënë në Grafikon 14.



**Grafiku 14**

Në lidhje me pyetjen “a do të merrte pjesë kompania juaj në vendosjen e sistemit për ndjekje të përkatësisë së nxënësve pas përfundimit të arsimit të mesëm profesional”, 13 të anketuar ose 46% janë përgjigjur pozitivisht, kurse 15 ose 54% janë përgjigjur negativisht.

Perceptimi i tillë i punëdhënësve dëshmon se ata janë të përgatitur në mënyrë gjysmake që të marrin pjesë në sistemin e ndjekjes së përkatësisë së nxënësve që kanë përfunduar arsimin e mesëm profesional.

## **5.5. Perceptimi i vetëqeverisjes lokale mbi ndjekjen e destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të procesit arsimor**

Nëpërmjet decentralizimit në Republikën e Maqedonisë ndodhën edhe ndryshime të caktuara në funksionalitetin e vendosur të sistemit arsimor. Kompetenca dhe ingjerenca të caktuara në lidhje me vendosjen dhe funksionimin e shkollave të mesme profesionale ranë në kompetencë të komunave, përkatësisht, vetëqeverisjes lokale. Si faktorë të drejtpërdrejtë kompetentë për ShMP-të, ndërsa nëpërmjet vetë kësaj edhe të sistemit arsimor, me rëndësi të madhe është perceptimi i vetëqeverisjes lokale mbi ndjekjen sistematike të nxënësve që kanë përfunduar shkollën e mesme. Informacionet e marra nga komunat dhe vetëdija e tyre për nevojat e të dhënave të përkatësisë, përkatësisht, destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të arsimit të mesëm profesional janë faktor i rëndësishëm për vendosjen dhe funksionimin e suksesshëm të sistemit të nxënësve që kanë përfunduar shkollën.

Perceptimi përfaqësuesve të sektorëve të arsimit në komunat: Veles, Tetovë, Strumicë, Ohër, Prilep, Gostivar, Kumanovë, Kavadarci, Manastir, Shtip, Aerodrom, Karposh, Çair dhe Qyteti i Shkupit e përcaktuan gjendjen dhe nevojën e ndjekjes sistematike të destinacioneve, përkatësisht, përkatësinë e nxënësve pas përfundimit të shkollës së mesme profesionale.

*Si është perceptimi i vetëqeverisjes lokale, përkatësisht komunave të përfshira në hulumtim në lidhje me ndjekjen e destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të procesit arsimor në shkollën profesionale?*

Në lidhje me pyetjen “a ka në suazat e komunës Tuaj shkollë të mesme profesionale”, 13 të anketuar ose 93% janë përgjigjur pozitivisht, kurse një i anketuar ose 7% është përgjigjur negativisht.

Perceptimi i tillë i komunave dëshmon se shkolla profesionale gjenden pothuajse në të gjitha rajonet ku ato shtrihen.

Deklaratat e komunave në lidhje me dhënien, përkatësisht identifikimin e shkollave të mesme profesionale të cilat gjenden në territoret e tyre dhe degët që realizohen në ato shkolla janë dhënë tërësisht.

Perceptimi i tillë dëshmon mbi bashkëpunimin e vendosur midis komunave dhe shkollave të mesme profesionale dhe njohje të strukturës së kualifikimit të kuadrit që del në nivel lokal.

Dëshmi për këtë konstatim është edhe deklarata e komunave në lidhje me pyetjen “a bashkëpunoni me shkollat e mesme profesionale në krijimin e politikës së regjistrimit në shkollë, shfaqjen e nevojës për program arsimor kompetent për një degë të caktuar”, kështu, tetë të anketuar ose 58% janë përgjigjur pozitivisht, dy të anketuar ose 14% janë përgjigjur negativisht, kurse katër të anketuar ose 28% kanë deklaruar se realizojnë bashkëpunim të pjesshëm.

Në lidhje me pyetjen “a kryeni në suazat e komunës suaj hulumtim për nevojat e tregut”, tre të anketuar ose 21% janë përgjigjur pozitivisht, gjashtë të anketuar ose 43% janë përgjigjur negativisht, kurse pesë të anketuar ose 36% kanë deklaruar se kryejnë hulumtim të pjesshëm të tregut të punës.

Perceptimi i tillë i komunave dëshmon për hulumtimin e pamjaftueshëm të tregut të punës kështu që nuk ekziston vazhdimësi në lidhje me të dhënat për nevojat e tregut të punës sepse nuk ka unifikim dhe qasje metodologjike në hulumtimet në nivel lokal.

Dëshmi për perceptimin e tillë të komunave mbi hulumtimin e pamjaftueshëm të tregut të punës janë edhe deklaratat e një pjesë të komunave të cilat thonë se hulumtimet të cilat i realizojnë janë për: përcaktim të nevojave për regjistrim të nxënësve të ardhshëm në shkollat e mesme profesionale, dhënie drejtim shkollave për profilet e nevojshme në përputhje me zhvillimin ekonomik dhe politikat e projektuara të komunave dhe sigurim të transparencës dhe informimit mbi mundësitë të cilat i ofron arsimit profesional në nivel lokal për nxënësit që do të futen në AMP.

Përgjigjet e komunave në lidhje me pyetjen “a ka komuna informacione/të dhëna statistikore se çfarë ndodh me nxënësit e arsimit të mesëm profesional pas përfundimit të arsimit të mesëm profesional”, janë: asnjë komunë nuk ka dhënë deklaratë pohuese, 11 komuna ose 79% kanë deklaruar se nuk kanë informacione/të dhëna statistikore, kurse tri komuna ose 21% kanë deklaruar se kanë informacione, përkatësisht të dhëna të pjesshme. Atë që komunat e japin si

posedim të pjesshëm të informacioneve/të dhënave statistikore janë të dhënat e APRM-së, të cilat siç thonë ato vetë nuk japin informacione relevante më të gjera.

Perceptimi i tillë flet për mungesën e informacioneve/të dhënave në nivel lokal për destinacionin e nxënësve pas përfundimit të procesit arsimor në shkollën profesionale.

Dëshmi për perceptimin e tillë të komunave janë edhe përgjigjet e komunave në lidhje me pyetjen “a ekziston sistem për ndjekjen e nxënësve pas përfundimit të arsimit profesional në sektorin arsimor të vetëqeverisjes Suaj lokale”, kështu të gjitha komunat kanë thënë se nuk ekziston.

Të gjitha komunat thonë se ekziston nevoja e ekzistimit të sistemit për ndjekje të nxënësve pas përfundimit të arsimit profesional, që dëshmon për vetëdijen e lartë tek vetëqeverisja lokale në aspektin e nevojës për ekzistencën e sistemit të tillë.

Ndryshe është gjendja e komunave në lidhje me posedimin e bazës së të dhënave për regjistrimin e nxënësve në shkolla. Deklaratat e komunave në lidhje me pyetjen “a posedojnë bazë të dhënash për regjistrim të nxënësve në shkollat e vetëqeverisjes Suaj lokale”, janë: nëntë të anketuar ose 64% janë përgjigjur pozitivisht, kurse pesë të anketuar ose 36% janë përgjigjur negativisht.

Perceptimi i tillë, flet se komunat kanë bërë përparim në lidhje me vendosjen e bazave të të dhënave për regjistrim të nxënësve në shkolla, edhe pse nuk duhet të anashkalohet fakti se një përqindje e theksuar e komunave nuk posedojnë të dhëna të tilla.


Komunat të cilat posedojnë baza të dhënash për regjistrim të nxënësve në shkollat e mesme profesionale shpesh i përdorin ato për: planifikim të numrit të nxënësve dhe paraleleve, shpërndarjen e orëve, organizim të arsimit, mbikëqyrje të gjendjes së nxënësve të regjistruar në ShMP, përcaktim të lëvizjes së nxënësve në komuna të tjera, krijim të politikës regjistruese në nivel lokal dhe përcaktim të gjendjes me potencialin e kuadrit.

Deklaratat e komunave në lidhje me faktin se si e vlerësojnë nevojën e ekzistimit të sistemit elektronik (zgjidhje softuerike) për ndjekjen e përkatësisë së nxënësve (të punësuar, të papunësuar, kanë vazhduar arsimin etj.) pas

përfundimit të arsimit të tyre në shkollën e mesme profesionale dhe krijimin e bazës së të dhënave për ta, është si vijon:

- për opsionet “nuk është i nevojshëm” dhe “është pak i nevojshëm” nuk është shprehur asnjë i anketuar;
- për opsionin “është i nevojshëm” janë shprehur tetë të anketuar ose 57% e numrit të përgjithshëm të të anketuarve;
- për opsionin “është shumë i nevojshëm” është shprehur një i anketuar ose 7% e numrit të përgjithshëm të të anketuarve; dhe
- për opsionin “është i domosdoshëm” janë shprehur pesë të anketuar ose 36% e numrit të përgjithshëm të të anketuarve.

Sinteza e rezultateve dëshmon se nevoja e ekzistimit të sistemit elektronik (zgjdhje softuerike) për ndjekjen e përkatësisë së nxënësve (të punësuar, të papunësuar, kanë vazhduar arsimin etj.) pas përfundimit të arsimit të tyre në shkollën e mesme profesionale dhe krijimi i bazës së të dhënave për ta në tërësi është në spektrin e “është i nevojshëm” dhe “është i domosdoshëm” siç është dhënë në Grafikon 15, rezultatet dëshmojnë për nevojën e padiskutueshme të ekzistimit të ndjekjes sistematike të lëvizjes dhe destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të arsimit të tyre të mesëm profesional.



## Grafiku 15

Në lidhje me identifikimin se kush duhet të kujdeset dhe duhet të mbushë bazën e të dhënave, perceptimi i vetëqeverisjes lokale është: katër komuna ose 29% konsiderojnë se për bazën e të dhënave duhet të kujdesen shkollat, dy komuna ose 14% konsiderojnë se këtë gjë duhet ta bëjnë vetë komunat, kurse tetë komuna ose 57% konsiderojnë se mirëmbajtja dhe mbushja e bazës së të dhënave duhet të bëhet nga ndonjë institucion tjetër siç janë: APRM-ja, QAPT-i, MASH-i, fakultetet dhe qendrat e veçanta ose institucionet e specializuara.

Perceptimi i tillë i vetëqeverisjes lokale dëshmon se në mirëmbajtjen dhe mbushjen e bazës së të dhënave duhet të përfshihen shumë institucione me rol, pjesëmarrje dhe përgjegjësi të ndarë.

Vetëqeverisja lokale më tepër thekson se ekzistimi i sistemit elektronik (zgjidhja softuerike) për ndjekjen e përkatësisë së nxënësve (të punësuar, të papunësuar, kanë vazhduar arsimin etj.) pas përfundimit të arsimit të tyre dhe krijimi i bazës së të dhënave për ta, do të shfrytëzohej në krijimin e politikës së regjistrimit dhe ndryshimet e argumentuara në rrjetin e shkollave profesionale. Dëshmi për perceptimin e tillë të vetëqeverisjes lokale janë edhe përgjigjet e komunave në lidhje me pyetjen “a mendoni se sistemi elektronik do t’ju ndihmonte në krijimin e politikës së regjistrimit në komunën Tuaj”, kështu 11 komuna ose 79% janë përgjigjur pozitivisht, tri komuna ose 21% janë përgjigjur se sistemi i tillë do t’i ndihmonte pjesërisht, kurse asnjë komunë nuk është përgjigjur negativisht për këtë pyetje.

Identifikimi i vetëqeverisjes lokale në lidhje me institucionet dhe prioritetin e tyre në përfshirje gjatë vendosjes së sistemit të ndjekjes sistematike, përkatësisht, përkatësinë e nxënësve pas përfundimit të arsimit të mesëm profesional është dhënë në Tabelën 7.

Kuantifikimi i perceptimit të shprehur në përqindje për nevojën e përfshirjes së një institucioni të caktuar është kryer në lidhje me tri kategori të përfshirjes: “duhet të përfshihet me patjetër”, “është e dëshirueshme të përfshihet” dhe “nuk duhet të përfshihet me patjetër”.



<b>Tabela 7. Kuantifikimi i vetëqeverisjes lokale mbi përfshirjen institucionale për ndjekje sistematike të arsimit të mesëm profesional</b>				
Nr. rendor	Institucioni	Duhet të përfshihet me patjetër (shprehje në %)	Është e dëshirueshme të përfshihet (shprehje në %)	Nuk duhet të përfshihet me patjetër (shprehje në %)
1.	Shkolla të mesme profesionale (ShMP)	64	22	14
2.	Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH)	79	21	0
3.	Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim (QAPT)	79	21	0
4.	Byroja për Zhvillim të Arsimit (BZHA)	36	50	14
5.	Qendra Shtetërore e Kontrollit (QShK)	7	79	14
6.	Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë (APRM)	79	21	0
7.	Universitete	36	50	14
8.	Bashkësia e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale (BNjVL)	71	22	7
9.	Inspektorati Shtetëror i Arsimit (ISHA)	21	21	58

Në përputhje me deklaratat e **komunave** për përfshirjen e institucioneve gjatë vendosjes së sistemit për ndjekje sistematike të destinacioneve, përkatësisht, përkatësisë së nxënësve pas përfundimit të arsimit të mesëm profesional, të treguara në **Tabelën 7** kemi:

- institucione të cilat duhet të përfshihen në ndjekjen sistematike të destinacioneve, përkatësisht, përkatësisë së nxënësve pas përfundimit të arsimit të mesëm profesional janë: ShMP, QAPT, MASH, APRM dhe BNjVL;

- institucione të cilat është e dëshirueshme të përfshihen në ndjekjen sistematike të destinacioneve, përkatësisht, përkatësisë së nxënësve pas përfundimit të arsimit të mesëm profesional janë: Universitetet, BZhA dhe QShK;
- institucion i cili nuk duhet të përfshihet në ndjekjen sistematike të destinacioneve, përkatësisht, përkatësisë së nxënësve pas përfundimit të arsimit të mesëm profesional është ISHA.

Perceptimi i tillë i vetëqeverisjes lokale është i përafërm me perceptimin e menaxhmentit të shkollave të mesme profesionale dhe punëdhënësve për përfshirjen e institucioneve gjatë vendosjes së sistemit për ndjekje sistematike të destinacioneve, përkatësisht, përkatësisë së nxënësve pas përfundimit të arsimit të mesëm profesional.

Sipas vlerësimit të komunave në lidhje me atë se cili do të ishte problemi më i madh gjatë vendosjes së sistemit për ndjekje të destinacioneve të nxënësve që kanë mbaruar shkollën, gjatë rangimit nga një deri në gjashtë, ku me njësh vlerësohet problemi më i madh, kurse me gjashtë problemi më i vogël, padyshim për problem më të madh theksohen mjetet e pamjaftueshme financiar dhe resurset njerëzore të patrajnuara, pastaj, vijojnë mungesa e kuantitetit të resurseve njerëzore, cilësia e pamjaftueshme e pajisjes, kuantiteti i pamjaftueshëm me pajisje, kurse për problem më të vogël konsiderohen kushtet e pamjaftueshme hapësinore. Skema e rangimit të komunave në lidhje me problemet e mundshme gjatë vendosjes së sistemit për ndjekje të destinacioneve të nxënësve që kanë përfunduar shkollën është dhënë me **Grafikun 16**.

Рангираност на проблемите од општините за системско следење на  
дестинациите на завршените ученици



**Grafiku 16**

## **5.6. Perceptimi i nxënësve, që kanë përfunduar arsimin, me status të personave të papunësuar mbi ndjekjen e destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të procesit arsimor**

Nxënësit që kanë përfunduar arsimin me status të personave të papunësuar janë kategoria e të anketuarve e cila mund të japë në mënyrë monitoruese vlerësim të nevojës të ndjekjes sistematike të destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të procesit arsimor. Para së gjithash, për arsye se ata e kanë kaluar procesin arsimor në shkollën profesionale dhe mund t'i thonë në mënyrë reale gjendjet në lidhje me nevojën e ndjekjes sistematike të destinacioneve të nxënësve që kanë mbaruar shkollën nga aspekti i pozitës së vet në të cilin gjenden. Në përputhje me deklaratat e të anketuarve të intervistuar të cilët kanë mbaruar arsimin e mesëm profesional mund të jepen perceptimet e mëposhtme:

- ❖ Shkollat nuk kanë strategji për promovim të mundësive për punësime të ardhshme të nxënësve që kanë mbaruar AMP. Kontaktet dhe bashkëpunimi i shkollave me kompanitë janë të dobëta, të rastësishme apo nuk ekzistojnë fare. Ekzistojnë raste individuale kur ndonjë nga arsimtarët i evidentojnë numrat e telefonit dhe adresën e jetesës të disa nxënësve, por nxënësit pas përfundimit të AMP-së nuk janë kontaktuar, as nuk janë informuar për mundësitë konkrete të punësimit.
- ❖ Në shkolla promovohen mundësi për vazhdimin e arsimit të lartë, nëpërmjet prezantimit të programeve studimore nga disa fakultet, ndërsa gjatë kësaj mjaft më e madhe është përfaqësimi i fakulteteve private.
- ❖ Pjesa më e madhe e personave të papunësuar të intervistuar (rreth 85%) i shfrytëzojnë shërbimet e internetit dhe kanë adresa elektronike. Të anketuarit e tjerë për arsye ekonomike nuk kanë kompjuterë.
- ❖ Pothuajse të njëzëshme janë deklaratat e të anketuarve se kanë dëshirë të mbeten në komunikim me shkollën pas përfundimit të arsimit të mesëm profesional.
- ❖ Të anketuarit shprehin përgatitje të tërësishme që vazhdimisht ta informojnë shkollën për destinacionet e tyre dhe për zhvillimin e tyre profesional.

- ❖ Të anketuarit konsiderojnë se në periudhë prej pesë (5) vjetësh pas përfundimit të AMP-së duhet të jenë në komunikim të vazhdueshëm me shkollën.
- ❖ Pjesa më e madhe e të anketuarve konsiderojnë se komunikimi me shkollën duhet të jetë deri në momentin e punësimit të tyre, kështu si përparësi të këtij procesi e theksojnë mundësinë që të ndihmohen gjatë punësimit, kurse shkollën nga kjo perspektivë e shohin si ndërmjetës midis tyre dhe kompanive. Përqindja më e madhe e të papunësuarve nuk mendojnë ta vazhdojnë arsimin e vet në fakultet për shkak të mungesës së mbështetjes financiare.
- ❖ Të gjithë të anketuarit pothuajse janë të njëzëshëm në deklaratat se procesi i komunikimit me shkollat duhet të mendohet, organizohet dhe realizohet mirë nga shërbimi profesional dhe personat e trajnuar. Preferojnë komunikim direkt i cili do të realizohet nëpërmjet takimeve në hapësirat e shkollës, ndërsa shkolla t'i informojnë në telefon për dinamikën e takimeve. Gjithashtu të anketuarit nuk janë kundër edhe për ndonjë lloj tjetër komunikimi me shkollat i cili është krijuar mirë.
- ❖ Të anketuarit e mbështesin iniciativën e vendosjes së sistemit për ndjekje të zhvillimit profesional të nxënësve edhe pas përfundimit të arsimit të mesëm profesional me qëllim që të fitohet ndihmë e vazhdueshme në zhvillimin e personalitetit. Janë të njëzëshëm në lidhje me qëndrimet se vendosja e sistemit për ndjekje të destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të arsimit të mesëm profesional është i domosdoshëm.

## **5.7. Perceptimi i institucioneve kompetente për arsimin e mesëm profesional për ndjekjen e destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të procesit arsimor**

Institucionet kompetente të arsimit të mesëm profesional (MASH, BZhA dhe QAPT) duhet të dinë me patjetër se çfarë ndodh me nxënësit pas përfundimit të arsimit të mesëm profesional që të mund t'i planifikojnë dhe fillojnë përmirësimet në sistemin arsimor.

Perceptimi i përfaqësuesve të institucioneve kompetente për AMP (MASH, BZhA dhe QAPT) e përcaktojnë gjendjen dhe nevojën e ndjekjes sistematike të destinacioneve, përkatësisht, përkatësinë e nxënësve pas përfundimit të arsimit të mesëm profesional.

Në përputhje me deklaratat e të anketuarve të intervistuar nga institucionet kompetente për arsimin e mesëm profesional mund të jepen perceptimet institucionale të mëposhtme:

- ❖ Nuk ekziston sistem për ndjekje të përkatësisë së nxënësve (të punësuar, të papunësuar, kanë vazhduar me arsimin etj.) pas përfundimit të arsimit të tyre.
- ❖ Nuk mbahet evidencë për mbledhjen e informacioneve të cilat do t'i përgjigjen pyetjes se çfarë ndodh me nxënësit pas përfundimit të AMP-së.
- ❖ Shumë e nevojshme është vendosja e një sistemi elektronik (zgjidhje softuerike) për ndjekjen e përkatësisë së nxënësve (të punësuar, të papunësuar, kanë vazhduar me shkollën etj.) pas përfundimit të arsimit të tyre dhe krijim të bazës së të dhënave për ta.
- ❖ Institucione të cilat duhet të përfshihen në krijimin, vendosjen dhe funksionimin e ndjekjes sistematike të përkatësisë së nxënësve që kanë përfunduar shkollën janë: ShMP-të, QAPT-i, MASH-i, APRM-ja dhe Universitetet, kurse është e dëshirueshme të përfshihen edhe: BZhA-ja, QShI-ja, BNjVL-ja dhe IShA.
- ❖ Për regjistrim në shkollat profesionale, MASH-i i shfrytëzon të dhënat e APRM-së, analizat në nivel lokal dhe politikën ekonomike të R. Maqedonisë në nivel makroekonomik.
- ❖ Parë në aspektin institucional, ekzistenca e një sistemi elektronik (zgjidhje softuerike) për ndjekjen e përkatësisë së nxënësve të (të punësuar, të

papunësuar, kanë vazhduar me arsimin etj.) pas përfundimit të arsimit të tyre dhe krijimi i bazës së të dhënave për ta: do të ndihmonte shumë për:

1. krijim të politikës së regjistrimit në shkollat profesionale;
  2. planifikim dhe zbatim të reformave plotësuese apo intervenimeve në arsimin profesional;
  3. planifikim më të mirë dhe më të tërësishme të procesit arsimor;
  4. harmonizim më të mirë të arsimit profesional me tregun e punës;
  5. optimizim të rrjetit të shkollave profesionale;
  6. dhënie drejtimi më të mirë profesional nxënësve;
  7. krijim të parakushteve dhe mundësive për ripërcaktim të degëve dhe profileve arsimore, përkatësisht, profilim të kuadrove të kërkuar nga tregu i punës.
- ❖ Në suazat e Universitetit “Shën. Kirill dhe Metodij” ekziston softuer i integruar universitar i cili mundëson evidencë përkatëse të studentëve, kështu që mund të merren edhe të dhëna për shkollat e mesme profesionale të nxënësve të regjistruar.

## **6. Mendime përmbyllëse për ndjekjen sistematike të destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të procesit të arsimit**

Në bazë të interpretimit dhe analizës së të dhënave të marra nga menaxhmenti, kuadri arsimor dhe nxënësit e shkollave të mesme profesionale, punëdhënësit, vetëqeverisja lokale, nxënësit që kanë mbaruar shkollën me status të personave të papunësuar dhe institucionet kompetente mbi arsimin e mesëm profesional për ndjekjen e destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të procesit arsimor në shkollat profesionale janë nxjerrë mendimet përfundimtare që vijojnë:

- ❖ Ndjekja sistematike e destinacioneve, përkatësisht, përkatësia e nxënësve pas përfundimit të arsimit të mesëm profesional nuk ekziston.
- ❖ Ekziston nevojë e shprehur fuqishëm për vendosje të ndjekjes sistematike të lëvizjes dhe destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të arsimit të tyre të mesëm profesional.
- ❖ Ekziston përgatitje e lartë e shkollave dhe të gjithë faktorëve relevantë që të marrin pjesë në ndërtimin e sistemit për ndjekje sistematike të destinacioneve, përkatësisht, përkatësisë së nxënësve pas përfundimit të AMP-së.
- ❖ Zgjidhje optimale për ndjekjen sistematike të destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të AMP-së do të ishte vendosja e sektorëve/shërbimeve të veçanta profesionale me përbërje heterogjene në suazat e institucioneve kompetente të cilat do të kujdesen për bazat e të dhënave dhe analizimin dhe shfrytëzimin e tyre në përputhje me nevojat arsimore.
- ❖ Institucionet të cilat duhet të përfshihen në ndjekjen sistematike të destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të AMP-së janë: shkollat e mesme, Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim, Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Universitetet dhe Bashkësia e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale.
- ❖ Ndjekja sistematike e destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të AMP-së duhet të dizajnohet sipas individit, të jenë gjithëpërfshirëse dhe të ekzistojnë baza të unifikuara të të dhënave.
- ❖ Nxënësit posedojnë një shkallë të lartë të arsimit informatik, përdorim i shërbimeve të internetit dhe përdorim i komunikimit me e-mail.



- ❖ Një përqindje e madhe e nxënësve dëshirojnë dhe mund të mbeten në komunikim me shkollën pas përfundimit të arsimit të mesëm profesional që të japin informacione në lidhje me destinacionet e tyre.
- ❖ Një përqindje e madhe e nxënësve shohin fitim personal në dhënien e informacioneve për destinacionet e tyre pas përfundimit të AMP-së.
- ❖ Periudha kohore prej pesë deri në shtatë vjet pas përfundimit të arsimit të mesëm profesional duhet të jetë e mjaftueshme për dhënie të informacioneve dhe ndjekje sistematike të individit.
- ❖ Projektimi dhe vendosja e ndjekjes sistematike e destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të arsimit duhet të mundësohet me komunikim heterogjen (sintezë e shumë lloje komunikimesh), ndërsa jo me një lloj komunikimi në shpërndarjen e informacioneve.
- ❖ Kërcënime potenciale gjatë vendosjes së sistemit për ndjekje të destinacioneve të nxënësve të kanë përfunduar arsimin janë: mjetet e pamjaftueshme financiare, resurset njerëzore të patrajnuara, mungesa e resurseve njerëzore dhe cilësia e pamjaftueshme e pajisjes.
- ❖ Në një përqindje më të madhe nuk ekziston bashkëpunim midis punëdhënësve dhe shkollave, kurse edhe nëse ekziston bashkëpunim, ai realizohet pjesërisht dhe përkohësisht.
- ❖ Punëdhënësit janë të hapur dhe të përgatitur për bashkëpunim me shkollat profesionale dhe shprehin nevojën për ndjekje sistematike të nxënësve që kanë përfunduar arsimin.
- ❖ Ekziston bashkëpunim i vendosur midis komunave me shkollat e mesme dhe njohje e strukturës së kualifikimeve të kuadrit i cili prodhohet në nivel lokal.
- ❖ Komunitat nuk kanë hulumtim përkatës të tregut të punës kështu që nuk ekziston vazhdimësi në lidhje me të dhënat për nevojat e tregut të punës.
- ❖ Komunitat nuk kanë informacione/të dhëna në nivel lokal për nxënësit pas përfundimit të procesit arsimor në shkollën profesionale, por ekziston vetëdije tek vetëqeverisja lokale për nevojën e ekzistimit të ndjekjes sistematike të nxënësve që kanë përfunduar shkollën.

- ❖ Ekzistimi i një sistemi elektronik (zgjidhje elektronike) për ndjekjen e përkatësisë së nxënësve (të punësuar, të papunësuar, kanë vazhduar me arsimin etj.) pas përfundimit të arsimit të tyre dhe krijimin e bazës së të dhënave për ta, më shumë do të ndihmonte në: krijimin e politikës regjistruese; planifikimin dhe zbatimin e reformave plotësuese apo intervenimeve në arsimin profesional; planifikimin më të mirë dhe më të tërësishëm të procesit arsimor; harmonizimin më të mirë të arsimit profesional me tregun e punës; optimizim i rrjetit të shkollave profesionale; drejtimin më të mirë profesional të nxënësve dhe krijimin e parakushteve dhe mundësive për ripërcaktim të degëve dhe profileve arsimore, përkatësisht, profilimin e kuadrove të kërkuar nga tregu i punës.
- ❖ Shkollat, por edhe institucionet (QAPT, MASH, BNjVL, APRM dhe Universitetet) të cilat duhet të përfshihen në vendosjen, funksionimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të ndjekjes së destinacioneve të nxënësve që kanë përfunduar arsimin nuk posedojnë kapacitete institucionale (organizuese, teknike-teknologjike, materiale, resurse kompetente njerëzore) dhe mjete financiare të nevojshme dhe të mjaftueshme që të vendoset ndjekje sistematike elektronike me baza të dhënash të vendosura, analizim dhe projektim të tyre në arsimin e mesëm profesional që të zmadhohet kapaciteti i tij.
- ❖ Mosekzistimi i sistemit për ndjekje të destinacioneve të nxënësve që kanë përfunduar arsimin çon në: transparencë të pamjaftueshme, shpërndarje të informacioneve të paargumentuara, përmbajtje jokompetente në informim dhe trajnim jokompetent i zhvillimit personal profesional.

## **7. Rekomandime për ndërtim të sistemit për ndjekje të destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të arsimit të mesëm profesional**

Në bazë të analizës së gjendjes me ndjekjen e destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të arsimit të mesëm profesional në Republikën e Maqedonisë, mendimeve përfundimtare të dala, si dhe rëndësisë së kësaj çështjeje në drejtim të përmirësimit të cilësisë së AMP-së, mund të jepen shumë rekomandime për ndërtimin e sistemit për ndjekje të destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të arsimit të mesëm profesional.

Rekomandimet do të ishin në funksion të vendosjes me sukses, mirëmbajtjes dhe zhvillimit të sistemit për ndjekje të destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të arsimit të mesëm profesional.

### **Rekomandime**

- Është e nevojshme të vendoset sistem për ndjekje të destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të AMP-së.
- Sistemi për ndjekje të destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të AMP-së në të gjitha segmentet e ndjekjes të ketë qasje individuale.
- Në vendosjen, funksionimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit për ndjekje të destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të AMP-së të përfshihen: shkollat, QAPT, MASH, BNjVL, APRM dhe universitetet, me procedura, role dhe kompetenca të përcaktuara saktësisht.
- Optimizimi i zgjidhjes së ndjekjes sistematike të destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të arsimit të bëhet me vendosje të sektorëve/shërbimeve të veçanta (të pavarur apo si pjesë përbërëse e shërbimeve të tjera të ngjashme të vendosura në shkollë, qendrat e karrierës etj.) me përbërje heterogjene të cilët do të kujdesen për bazat e të dhënave në lidhje me analizimin dhe shfrytëzimin e tyre.
- Nevojitet përforcim i kapaciteteve institucionale (organizative, teknike-teknologjike, materiale, resurset njerëzore kompetente) dhe sigurim i mjeteve

financiare që të vendoset ndjekje elektronike sistematike e nxënësve pas përfundimit të AMP-së me bazat e vendosura të të dhënave, analizim dhe projektim të tyre në arsimin e mesëm profesional që të zmadhohet cilësia e tij.

- Ndjekja sistematike e destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të arsimit të projektohet për periudhë kohore nga pesë deri në shtatë vjet pas përfundimit të arsimit të mesëm profesional.
- Aplikacionet e pakove softuerike të sigurojnë baza të unifikuara të dhënash në përputhje me kërkesat dhe nevojat për ndjekje sistematike të destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të AMP-së.
- Dizajnimi i kërkesave softuerike, përkatësisht bazave të të dhënave të jetë në përputhje me kornizat e të gjithë pjesëmarrësve relevantë dhe të sigurojnë të dhëna përkatëse për individin.
- Projektimi dhe vendosja e ndjekjes sistematike të destinacioneve të nxënësve që kanë përfunduar të mundësohet me komunikim heterogjen (sintezë të shumë llojesh komunikimi dhe shfrytëzim të kompetencave të mira informatike të individëve të ndjekur) dhe jo si një lloj komunikimi në shpërndarjen e informacioneve.
- Procesi i komunikimit dhe shpërndarjes së informacioneve në sistemin e ndjekjes së destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të arsimit të mesëm profesional duhet të mendohet, organizohet dhe realizohet mirë nga shërbimi profesional me persona profesionistë kompetentë për përpunimin statistikor të të dhënave dhe analizim të tyre në përputhje me nevojat arsimore që të përmirësohet cilësia e procesit arsimor.
- Shkollat ta përforcojnë bashkëpunimin me kompanitë dhe fakultetet dhe të ndërmarrin rolin e ndërmjetësit për lidhje të nxënësve të tyre që kanë përfunduar arsimin me tregun e punës dhe arsimin lartë.

Analiza e pasqyron gjendjen e sotshme dhe i përcakton nevojat e ndjekjes së destinacioneve pas përfundimit të AMP-së në bazë të perceptimeve të menaxhmentit, kuadrit arsimor dhe nxënësve të shkollave të mesme profesionale, punëdhënësve, vetëqeverisjes lokale, nxënësve që kanë përfunduar shkollën dhe

kanë status të personave të papunësuar dhe institucioneve kompetente për arsimin e mesëm profesional.

Analiza duhet të hapë mundësi për përmirësim të gjendjes në lidhje me ndjekjen sistematike të destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të AMP-së, kurse nëpërmjet kësaj kjo të prodhojë cilësi të zmadhuar në arsimin profesional.

Analiza duhet kontribuojë në krijimin dhe ndërtimin e një modeli për ndjekje të destinacioneve të nxënësve pas përfundimit të AMP-së, model i cili duhet të kontribuojë në vendosjen e rrugës së ndryshimeve pozitive në kulturën organizative-teknike të institucioneve arsimore, në standardizimin e njohurive të caktuara në raport me ndjekjen e AMP-së, kurse gjithashtu duhet të jetë provokim për hulumtime të mëtejshme në këtë fushë dhe për zhvillim të modeleve dhe zgjidhjeve të reja për përmirësim të cilësisë së arsimit të mesëm profesional.